



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI**

DRAFT 3 version 3

LIGJ

Nr _____, date _____

PER LEJET E MJEDISIT*

**Në mbështetje të Neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës me propozim të
Këshillit të Ministrave,**

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

* Ky Ligj adopton Direktiven 2008/1/EC lidhur me kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes e ndryshuar nga Direktiva 2009/31/EC; dhe Direktivën 2001/80/EC mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotesve në ajër nga instalimet e medhenj me diegie, e ndryshuar nga Direktiva 2009/31/EC.

Ky Ligj gjithashtu adopton kërkesat e përgjithshme për sistemin e lejeve të mjedisit sipas përcaktimeve të Direktivave (që më vonë duhet të transpozohen plotësisht me akte të posaçme): Direktiva 94/63/EC mbi kontrollin e shkarkimeve të perberjeve organike volatile (VOC) si pasojë e magazinimit të karburanteve dhe shpërndarjen e tyre nga depozitat e shpërndarjes në stacionet e shërbimit; Direktiva 2008/98/EC mbi Mbetjet; Direktiva 1999/31/EC mbi Landfilllet e mbetjeve; Direktiva 2000/76/EC mbi Incenerimin e Mbetjeve; Direktiva 94/62/EC mbi ambalazhet dhe mbetjet prej ambalazheve, e ndryshuar nga Direktiva 2004/12/EC dhe Direktiva 2005/20/EC; Direktiva 2002/96/EC mbi Mbetjet e Paisjeve Elektrike dhe Elektronike, e ndryshuar nga Direktiva 2003/108/EC dhe Direktiva 2008/34/EC; Direktiva 2000/53/EC mbi automjetet në fund të jetës, e ndryshuar nga Direktiva 2008/33/EC dhe nga Vendimet 2002/525/EC, 2005/63/EC, 2005/438/EC dhe 2008/689/EC; Direktiva 91/271/EEC lidhur me Trajtimin e Ujrave të Ndotur Urban, e ndryshuar nga Direktiva 98/15/EC; Direktiva 86/278/EEC mbi Mbrojtjen e Mjedisit, dhe në mënyrë të veçantë të tokës, kur mbetjet e ngurta të ujërave të zeza përdoren në bujqësi, e ndryshuar nga Direktiva 91/692/EEC; Direktiva 2004/42/EC mbi kufizimin e shkarkimeve të perberjeve organike volatile si pasojë e përdorimit të tretësive organike (solvents) në disa bojra, llaqeve dhe produkteve ilustruese të automjeteve e ndryshuar nga Direktiva 2008/112/EC.

Kreu 1

Dispozita te përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetes.

Neni 2

Objekti

1. Ky ligj përcakton rregullat për lejimin e zhvillimit të disa kategorive të veprimtarive ndotëse në Republikën e Shqipërisë, masat e parashikuara për parandalimin e ndotjes së mjedisit, dhe kur kjo nuk është e mundur, masat për reduktimin e shkarkimeve në ajër, ujë dhe toke, si dhe masat për reduktimin e mbetjeve të gjeneruara nga këto veprimtari.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllimet e këtij ligji termat e mëposhtem do të kenë këto kuptime:
 - (a) **“Autoriteti perkates i Qeverisjes Vendore”** është njësia e qeverisjes vendore në territorin e të cilës është vendosur instalimi;
 - (b) **“Agjencia Kombetare e Mjedisit”** ka kuptimin e dhënë në Ligjin “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
 - (c) **“Agjencia Rajonale e Mjedisit”** është njësia rajonale përkatëse e Agjencisë Kombetare të Mjedisit;
 - (d) **“Depozitim Gjeologjik i CO₂”** është injektimi i shoqëruar me depozitimin e rrymave (flukseve) të CO₂ në formacione gjeologjike nëntokesore;
 - (e) **“Dite”** është një ditë punë sipas përcaktimit të dhënë nga Kodi i Punës;
 - (f) **“Formacion Gjeologjik”** është nën-ndarja lithostratigrafike brenda të cilës mund të gjenden dhe hartëzohen shtresa shkembore të caktuara;
 - (g) **“Instalim”** është çdo njësi teknike e palëvizshme që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie që lidhet drejtpërdrejt me të,

apo ka një lidhje teknike me veprimtaritë e zhvilluara në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;

- (h) **“Instalim ekzistues”** është:
- i. një instalim që është në funksionim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji; ose
 - ii. një instalim që nuk është vënë ende në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi, por për të cilin është dhënë leja e ndërtimit sipas përcaktimit të ligjit **Nr...dt...”Për Planifikimin të Territorit”**, dhe ndërtimi i të cilit fillon brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- (i) **“Instalim i ri”** është:
- i. një instalim i ndryshëm nga një instalim ekzistues;
 - ii. një instalim ekzistues, për funksionimin e të cilit, brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj, operatori nuk ka kërkuar pajisjen me lejen perkatese të mjedisit. Në këtë rast ky instalim trajtohet si një instalim i ri.
- (j) **“Inspektorati Kombëtar i Mjedisit”** është autoriteti inspektues sipas përcaktimit të dhënë në Ligjin Nr...dt... “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- (k) **“Leje mjedisore e tipit A”** kupton vendimin me shkrim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit që i jep të drejtën e funksionimit tërësisht ose pjesërisht instalimit të tipit A sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;
- (l) **“Leje mjedisore e tipit B”** kupton vendimin me shkrim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit që i jep të drejtën e funksionimit tërësisht ose pjesërisht instalimit të tipit B sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;
- (m) **“Leje mjedisore e tipit C”** kupton vendimin me shkrim të Autoritetit të Qeverisjes Vendore që i jep të drejtën e funksionimit tërësisht ose pjesërisht instalimit të tipit C sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;
- (n) **“Mjedis”** ka kuptimin e dhënë në Ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- (o) **“Ministër”** është Ministri përgjegjës për Mbrojtjen e Mjedisit;
- (p) **“Ministria”** është Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;

- (q) **“Mbetje te rrezikeshme”**, “Mbetje jo-te rrezikeshme”, “Mbetje inerte”, “Mbetje urbane” dhe “Lendfill”, kanë kuptimin e dhënë ne Ligjin Nr...dt...”Mbi menaxhimin e mbetjeve”;
- (r) **“Muaj”** eshte nje muaj kalendarik;
- (s) **“Ndotje”** ka kuptimin e dhënë ne Ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- (t) **“Ndryshim funksionimi”**, ne lidhje me instalimin, eshte një ndryshim ne natyrën e funksionimit, ose një zgjerim i veprimtarise se tij qe mund te ketë pasoja ne mjedis;
- (u) **“Ndryshim i konsiderueshëm”** ne lidhje me instalimin, është një ndryshim ne funksionim e tij, i cili në vleresimin e Agjencisë Kombetare te Mjedisit mund te ketë një efekt negativ te konsiderueshëm mbi jeten e njerëzve dhe mjedisin. Çdo ndryshim apo zgjerim i veprimtarise vleresohet si i konsiderueshëm nëse ndryshimi apo zgjerimi prek kufijte percaktues te vendosura ne kete ligj, per instalimet e tipit A ose B;
- (v) **“Normat e cilësisë se mjedisit”** janë një grup kushtesh qe duhen përmbushur ne një kohe te dhënë nga një mjedis i caktuar ose një pjese e veçante e tij, sipas percaktimit të Ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- (w) **“Normat teknike të mjedisit”** janë vlerat teknike kufi te shkarkimit qe lidhen me teknologjinë e prodhimit, makineritë dhe pajisjet ne përdorim, sipas percaktimit të Ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- (x) **“Operator”** është personi fizik apo juridik që operon apo kontrollon instalimin, apo të cilit i është deleguar fuqi ekonomike vendimtare për funksionet teknike të instalimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- (y) **“Publik”** ka kuptimin e dhënë ne Ligjin “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
- (z) **“Qendra Kombëtare e Licencimit”** nënkupton Institucionin perkates sipas percaktimit te ligjit Nr 10081 i datës 23.02.2009 “Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”;
- (aa) **“Rryme CO₂”** eshte nje fluks substancash qe krijohen si rrjedhoje e procesit te kapjes se CO₂;
- (bb) **“Substance”** është çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim te substancave radioaktive dhe te organizmave te modifikuar gjenetiksht, sipas përcaktimit te dhëne ne Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit;
- (cc) **“Shkarkim”** ka kuptimin e dhënë ne Ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- (dd) **“Shkarkim ne ujë”** nenkupton shkarkimet ne trupat ujore ku perfshihen shkarkimet ne rrjetin e tubacioneve te ujrave te zeza;

- (ee) "**Teknikat me te Mira te Disponueshme**" (TMD) eshte faza me e efektshme dhe e avancuar ne zhvillimin e veprimtarive dhe ne mënyrën e tyre te funksionimit. Kjo faze vleresohet si e tille duke u mbeshtetur ne përshtatshmërinë praktike te një teknike te veçante për te respektuar ne parim normat me te uleta te vlerave kufi te shkarkimeve, te përcaktuara, me qellim parandalimin dhe kur kjo nuk është e zbatueshme, për te reduktuar ne përgjithësi shkarkimet dhe ndikimet ne mjedis. Për qëllimin e këtij përkufizimi:
- i. "**teknikë**" kupton si teknologjinë ashtu edhe mënyrën ne te cilen instalimi është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe ç'montuar
 - ii. "**teknikë e disponueshme**" kupton teknikat e zhvilluara ne atë nivel qe mundëson perdorimin e tyre ne sektorin përkatës industrial me rezultate te mira ekonomike dhe teknike. Vleresimi i teknikave merr parasysh kostot dhe perparesite pavarësisht nga fakti nëse ato teknika përdoren apo prodhohen ne Republikën e Shqipërisë, përse kohe ato jane te arritshme nga përdoruesi;
 - iii. "**me e mire**" ne lidhje me teknikat, kupton efektshmerine në arritjen e një niveli te larte te përgjithshëm te mbrojtjes se mjedisit ne tërësi.
- (ff) "**Vlera Kufi e Shkarkimit**" është masa e shprehur ne disa parametra specifike, përqendrimet dhe/ose nivelet e shkarkimeve qe nuk mund te tejkalohen ne një ose me shume periudha kohore;
- (gg) "**Vend depozitimi per CO₂**" eshte nje hapësire vellimore ne nje formacion gjeologjik qe perdoret per depozitimin gjeologjik te CO₂ dhe te paisjeve te sipërfaqes dhe injektimit qe perdoren per kete qellim;

2. Për qëllimet e këtij ligji:

- (a) Kur një instalim nuk është vene akoma ne funksionim, personi qe do te kontrolloje funksionimin e tij trajtohet si operatori i këtij instalimi;
- (b) Kur një instalim nuk funksionon me, personi te cilit i eshte dhene leje mjedisi per funksionimin e këtij instalimi, konsiderohet si operatori i këtij instalimi.

3. Për qëllimet e Kreut 2, seksioni 4 te këtij ligji termat e mëposhtëm kuptojne:

- (a) '**Biomase**' nënkupton produkte te përbëra tërësisht ose pjesërisht nga material bimor nga bujqësia ose pemëtaria qe mund te përdoret si lende djegese me qellim rikuperimin e energjisë se përmbajtur ne te, perfshire mbetjet e mëposhtme te përdorura si lende djegese:
 - i. mbetje vegjetale nga bujqësia dhe pyjet;
 - ii. mbetje vegjetale nga industria e përpunimit te ushqimeve, nëse prej tyre mund te çlirohet nxehtësi;

- iii. mbetje vegjetale fijeze nga prodhimi i masës së celulozës dhe nga prodhimi i letës nga druri, nëse digjen bashkërisht në vendin e prodhimit dhe rikupërohet nxehësia e çliruar;
 - iv. mbetje nga levoret e pemëve;
 - v. mbetje drusore me përjashtim të mbetjeve drusore që mund të përmbajnë perberës organik të halogjenuar ose metale të rënda si rezultat i trajtimit me ruajtës ose me shtresa ruajtëse të drurit, dhe që përfshin në mënyrë të veçantë mbetjet drusore të krijuara nga mbetjet e ndërtimeve dhe të shembjeve;
- (b) **‘Impjant me djegie’** nënkupton çdo aparaturë teknike ku oksidohen lende djegëse në mënyrë që të përdoret nxehësia e gjeneruar;
- (c) **‘Impjantet e reja me djegie’** nënkupton çdo instalim me djegie, për të cilin leja e zhvillimit të veprimtarisë është dhënë në datën e miratimit të këtij ligji apo pas saj [Per tu vendosur nga ministria]. Mund të lihet edhe një periudhë tranzicioni, nëse gjykohet se ka nevojë për kohë.
- (d) **‘Impjantet ekzistuese me djegie’** nënkupton çdo instalim me djegie për të cilin leja e zhvillimit të veprimtarisë është dhënë para datës së miratimit të këtij ligji.
- (e) **‘Lende djegëse’** nënkupton çdo material të djegshëm të ngurtë, të lëngshëm apo të gaztë të përdorur në instalimin me djegie, me përjashtim të mbetjeve sipas përcaktimit të Ligjit Nr...dt... “Për menaxhimin e mbetjeve”;
- (f) **‘Mbetje të gazta’** janë shkarkime të gazta që përmbajnë substanca të ngurta, të lëngshme ose të gazta; fluksi vëllimor i tyre do të shprehet në metra kub/ore, në temperaturën standard (273°K) dhe presion (101,3 kPa) pas korrigjimit të përmbajtjes së avullit të ujit, me poshtë referuar si (Nm³/h);
- (g) **‘Njësi djegie me shumë lende djegëse’** nënkupton çdo impjant djegie ku mund të digjen njëkohësisht ose në mënyrë të alternuar dy ose me shumë lloje lëndesh djegëse;
- (h) **‘Turbine me gaz’** do të thotë çdo makineri rrotulluese që shndërron energjinë termike në punë mekanike, dhe përbehet kryesisht nga një kompresor, një njësi termike ku oksidohet lenda djegëse në mënyrë që të ngrohet masa e lëngshme të punës, dhe një turbine.
- (i) **‘Vlera kufi e shkarkimeve’** është sasia e lejueshme e një substance në masën e gaztë të shkarkuar në ajër nga instalimi me djegie gjatë një periudhe të dhënë. Sasia e substancës llogaritet në terma të masës/për vëllim të gazeve të shkarkuara, të shprehura në mg/Nm³, duke konsideruar një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara: prej 3 % në rastin e karburanteve të lëngshëm dhe të gaztë, 6 % në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 % në rastin e turbinave me gaz;

- (j) **‘Shkalla e desulfurizimit’** nënkupton përqindjen e sasisë së squfurit që nuk shkarkohet në ajër në instalimin me djegie për një periudhë të dhënë kohe ndaj sasisë së squfurit në përmbajtjen e karburantit të përdorur gjatë së njëjtes periudhe kohe, në këtë instalim;

Neni 4

Sistemi i lejeve

1. Në përputhje me Ligjin Nr...Dt...”Për Mbrojtjen e Mjedisit” vendoset një sistem prej tre nivelesh të lejeve të mjedisit.
2. Paisja me leje mjedisi të tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A. Përcaktimi i kushteve të detajuara, verifikimi i plotësimit të tyre si dhe dhënia e lejes së tipit A subjektit kerkues, është kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
3. Kategoria A e veprimtarive dhe çdo kufi që përcakton nëse një veprimtari është subjekt i saj, përcaktohet në Shtojcën 1/A të këtij ligji.
4. Paisja me leje mjedisi të tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B. Përcaktimi i kushteve të detajuara, verifikimi i plotësimit të tyre si dhe dhënia e lejes së tipit B subjektit kerkues, është kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
5. Kategoria B e veprimtarive dhe çdo kufi që përcakton nëse një veprimtari është subjekt i saj, përcaktohet në Shtojcën 1/B të këtij ligji.
6. Paisja me leje mjedisi të tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C. Dhënia e lejes së tipit C subjektit kerkues, është kompetencë e Autoritetit përkatës të Qeverisjes Vendore.
7. Kategoria C e veprimtarive dhe çdo kufi që përcakton nëse një veprimtari është subjekt i saj, përcaktohet në Shtojcën 1/C të këtij ligji.

Kreu 2

Lejet e mjedisit të tipit A

Seksioni 1

Procedura dhe metoda për përcaktimin e teknikës me të mirë të disponueshme.

Neni 5

Teknika me të Mirë të Disponueshme

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton Teknikën me të Mirë të Disponueshme, me poshtë referuar si TMD, për instalimet e kategorisë së tipit A duke u mbështetur në:

- (a) Përdorimin e teknologjisë që shkarkon pak mbetje;
- (b) Përdorimin e substancave me pak të rrezikshme;
- (c) Rikuperimin dhe riciklimin e mëtejshëm të substancave të përdorura dhe të çliruara nga proceset e punës, aty ku është e mundur;
- (d) Rikuperimin dhe riciklimin mbetjeve, aty ku është e mundur;
- (e) Procese, instalime ose metoda pune të krahasueshme me ato që janë provuar më parë me sukses në shkallë industriale;
- (f) Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuritë shkencore dhe kuptimin e tyre;
- (g) Llojin, natyrën, efektet dhe vëllimin e shkarkimeve;
- (h) Datën e vënies në funksionim të instalimeve të reja dhe ekzistuese;
- (i) Periudhën e kohës së nevojshme për të zbatuar Teknikat me të Mira të Disponueshme;
- (j) Llojin, natyrën dhe konsumin e lendeve të para, përfshirë edhe konsumin e ujit të përdorur si dhe eficienten e tyre energjetike;
- (k) Eficienten e energjisë
- (l) Nevojen për të parandaluar, ose kur kjo nuk është e mundur, për të ulur në minimum, ndikimet e përgjithshme të shkarkimeve në mjedis dhe rreziqet në mjedis;
- (m) Nevojen për të parandaluar aksidentet ose kur këto ndodhin, për të minimizuar pasojat në mjedis;
- (n) Çdo informacion të publikuar nga Komisioni Evropian dhe organizatat ndërkombëtare mbi Teknikat me të Mira të Disponueshme, së bashku me monitorimin dhe çdo përditësim të tyre.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjatë përcaktimit të Teknikave me të Mira të Disponueshme në përputhje me sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, merr në konsideratë:

- (a) kostot dhe përfitimet e një veprimi dhe/ose mase të parashikuara;
- (b) respektimin e objektivave të mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e mjedisit; dhe
- (c) respektimin e parimeve të politikës për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Neni 6

Dokumentet e references për Tekniken me te Mire te Disponueshme

1. Përcaktimi i TMD ne përputhje me Nenin 5 te ketij ligji, mbeshtetet ne:
 - (a) dokumentet e references se TMD-ve te pergatitura nga Grupet Teknike te Punes;
 - (b) dokumentet e references se TMD-ve te përgatitura nga Komisioni Evropian (EU-BREFs);
 - (c) praktika me e mire ndërkombëtare.
2. Ministri ngre Grupet Teknike te Punes me qellim zhvillimin e dokumenteve te references se Teknikave me te Mira te Disponueshme sipas percaktimit te pikes 1 (a) te ketij neni dhe percakton menyren e funksionimit te tyre.
3. Grupet teknike te punës sipas percaktimit te pikes 2 te ketij neni përbehen nga perfaqesues te;
 - (a) Ministrise;
 - (b) Agjencise Kombetare te Mjedisit;
 - (c) Inspektoratit Kombëtar te Mjedisit;
 - (d) Ministrive te tjera, kur sfera e tyre e kompetencave lidhet drejtperdrejt me çeshtjen e trajtuar;
 - (e) Sektorit te industrise, fusha e veprimit e te cilit lidhet drejtperdrejt me çeshtjen e trajtuar;
 - (f) Organizatave perfaqesuese te industrise, fusha e veprimit e te cileve lidhet drejtperdrejt me çeshtjen e trajtuar;
 - (g) Universiteteve ose institucioneve te tjera kërkimore, fusha e kerkimit e te cileve lidhet drejtperdrejt me çeshtjen e trajtuar;
 - (h) Organizatave jo-qeveritare, fusha e veprimit e te cilave lidhet drejtperdrejt me çeshtjen e trajtuar.
4. Çdo dokument reference i TMD – se i përgatitur nga një Grup Teknik Pune sipas pikes 2 te ketij neni, miratohet nga ministri.
5. Çdo dokument reference i TMD-se i miratuar sipas percaktimit te pikes 4 te ketij neni, publikohet ne menyre elektronike.
6. Agjencia Kombetare e Mjedisit ngre dhe mirëmban sistemin e informacionit mbi dokumentet e referuara ne piken 1 te ketij neni. Sistemi i informacionit eshte i hapur për publikun dhe informacioni i ruajtur ne te eshte i mundur per tu marre ne menyre elektronike.

Neni 7

Zhvillimi i TMD – ve te reja

Ministria dhe Agjencia Kombetare e Mjedisit marrin dhe perditesojne informacionin mbi zhvillimin e TMD-ve te reja.

Seksioni 2

Lejet e mjedisit te tipit A

Neni 8

Kerkesat thelbesore per perdorimin e lejes se mjedisit te tipit A

1. Instalimet e kategorise A nuk funksionojne pas hyrjes ne fuqi te ketij ligji perveç rasteve kur kjo lejohet nga leja e mjedisit e tipit A, miratuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, ne perputhje me sa parashikohet ne nenin 52 te ketij ligji.
2. E njejta leje mjedisi e tipit A mund te lejoje funksionimin e me shume se një instalimi te te njëjtit operator ne te njëjtin vend. Instalimet e operatorve te ndryshem qe ndodhen ne te njëjtin vend dhe instalimet e te njëjtit operator qe ndodhen ne vende te ndryshme kerkojne leje te vecanta të tipit A, B apo C, sipas rastit.
3. Leja e mjedisit e tipit A nuk leshohet nëse Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se ky subjekt pas zoterimit se lejes se mjedisit te tipit A nuk do/mund te kontrolloje funksionimin e instalimit ose nese subjekti nuk siguron qe instalimi ne fjale do te funksionojë sipas kushteve te percaktuara ne lejen perkatese te mjedisit te tipit A.

Neni 9

Parimet e pergjithshme qe percaktojne detyrimet thelbesore te zoteruesit te lejes se mjedisit te tipit A

1. Agjencia Kombetare e Mjedisit percakton kushtet për lejet e mjedisit te tipit A, te tilla qe te garantojne se:
 - (a) janë marre te gjitha masat e duhura parandaluese te ndotjes, ne menyre te posaçme permes zbatimit te teknikave me te mira te disponueshme;
 - (b) nuk shkaktohet ndotje ne nivel te larte;
 - (c) prodhimi i mbetjeve është shmangur ne përputhje me Ligjin Nr...dt..."Për menaxhimin e mbetjeve". Aty ku prodhohen mbetje ato riperdoren ose kur kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e pamundur ato trajtohen duke shmangur ose zbutur çdo ndikim ne mjedis;
 - (d) energjia përdoret ne mënyre te efektshme;
 - (e) uji përdoret ne mënyre te efektshme;

- (f) janë marre masa të posaçme për të parandaluar aksidentet ose për të kufizuar pasojat e tyre; dhe
- (g) në mbylljen përfundimtare të veprimtarisë, merren masat e nevojshme për të mënjanuar rreziqet e ndotjes dhe për të kthyer vendin ku ndodhet instalimi në gjendje të pranueshme.

Neni 10

Kerkesat e posaçme për percaktimin e kushteve të lejes së mjedisit të tipit A

1. Leje e mjedisit të tipit A për çdo instalim percakton:
 - (a) Vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, në mënyrë të veçantë të atyre në shtojcën 2 të këtij ligji, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi në fjalë, duke u mbështetur në natyrën dhe potencialin e tyre për të transferuar nga një perberës i mjedisit në një tjetër;
 - (b) Vlerat kufi të shkarkimeve sipas percaktimit të gërmes (a), pika 1 e këtij neni, që zbatohen për grupet e ndotësve dhe jo për ndotës të veçantë, kur kjo është e mundur;
 - (c) Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas percaktimit të gërmes (a) pika 1 e këtij neni, që zbatohen në pikën ku shkarkimet dalin nga instalimi pavarësisht hollimit që mund t'i ndodhë atyre në distancë nga kjo pikë. Në rastin e shkarkimeve jo-të drejtpërdrejta në ujë, gjatë llogaritjes së vlerave kufi të shkarkimeve të instalimit në fjalë, merret në konsideratë edhe përdorimi i një instalimi për trajtimin e ujit me kusht që të garantohet një nivel i njëjtit i mbrojtjes së mjedisit në teresi dhe që një gjë e tillë të mos shkaktojë nivele me larta ndotje në mjedis;
 - (d) Kur normat teknike për funksionimin e një instalimi, janë vendosur në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve ose të zhurmave apo akte të tjera normative në fuqi që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, ato vleresohen si vlerat kufi maksimale të shkarkimeve, sipas percaktimit të gërmes (a), pika 1 e këtij neni;
 - (e) Në përputhje me gërmen (g) të këtij neni percaktimi i vlerave kufi të shkarkimeve sipas percaktimit të gërmes (a) të këtij neni mbështetet në TMD për llojin e instalimit në fjalë, por jo në ndonjë teknikë ose teknologji të veçantë. dhe në çdo rast merr parasysh karakteristikat teknike të instalimit, vend-ndodhjen e tij gjeografike dhe kushtet e mjedisit në atë zonë.
 - (f) Vlerat kufi të shkarkimeve sipas percaktimit të gërmes (a), pika 1 e këtij neni për instalimet e referuara në pikat A.6.5 dhe 6.6 të shtojcës 1.A të

ketij ligji, mbeshteten ne vleresime praktike te përshtatshme për këto kategori instalimesh.

- (g) Kur norma e cilësisë se mjedisit per nje instalim percakton vlera shkarkimesh me te uleta se ato te vendosura ne vlerat kufi te shkarkimeve sipas percaktimit te germes (e), pika 1 e ketij neni, atëherë vlerat kufi te shkarkimeve te percaktuara nga norma e cilësisë se mjedisit, zbatohen per instalimin;
- (h) Lendfilli që mbulohet nga pikat 5.1 dhe 5.4 në Shtojcën 1.A konsiderohet se plotëson kërkesat teknike të këtij ligji nqse ai plotëson kërkesat teknike për lendfille të tilla, sic përcaktohet në legjislacion tjetër për lendfillet;
- (i) Sipas rastit, vlerat kufi te shkarkimeve sipas percaktimit te germes (a), pika 1 e ketij neni, mund te plotesohen ose zëvendësohen nga parametra te njejte ose masa teknike.

2. Leja e mjedisit e tipit A përfshin gjithashtu kushte që:

- (a) Synojnë të minimizojne ndotjen ne distance te largët ose ndotjen ndërkufitare;
- (b) sigurojne një nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit ne tërësi;
- (c) sigurojne mbrojtjen e tokës nëse është e nevojshme;
- (d) sigurojne mbrojtjen e ujërave nëntokësore nëse është e nevojshme;
- (e) sigurojne menaxhimin e duhur të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi nëse është e nevojshme;
- (f) percaktojne kerkesa te përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve që specifikojnë metodologjinë dhe frekuencën e matjeve dhe procedurën e vlerësimit, dhe qe sigurojne se zoteruesi i lejes i jep Agjencisë Kombetare te Mjedisit dhe Inspektoratit Kombëtar te Mjedisit te dhënat e kërkuara për te kontrolluar përmbushjen e kushteve te lejes se mjedisit te tipit A. Gjithsesi, për instalimet e referuara ne pikat A.6.5 dhe 6.6 te shtojces 1.A te ketij ligji, kërkesat e kësaj germe marrin parasysh edhe kostot dhe përfitimet;
- (g) janë te përshtatshme per periudhat kur instalimi nuk funksionon normalisht dhe ekziston rreziku i nje ndikimi ne mjedis. Keto kerkesa kane te bejne me fillimin e operacioneve, rrjedhjet, keqfunksionimet, ndalesat e perkohshme dhe ndalimin përfundimtar te operacioneve;
- (h) percaktojnë hapat qe duhen ndërmarrë përpara vënies ne pune te instalimit;
- (i) percaktojnë hapat qe duhen ndërmarrë pas ndalimit përfundimtar te operacioneve të instalimit;

- (j) kërkojnë që operatori t'i sigurojë rregullisht Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Kombëtar të Mjedisit rezultatet e monitorimit të shkarkimeve;
 - (k) kërkojnë që operatori të informojë pa vonesë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, për çdo incident ose aksident që po ndikon apo mund të ndikojë seriozisht në mjedis; dhe
 - (l) kur është e nevojshme, kërkohen specifikisht nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për arritjen e qëllimeve të këtij ligji.
3. Leja e mjedisit e tipit A nuk e përfshin vlerën kufi për shkarkimet e drejtpërdrejta të gazrave serrë nëse shkarkimet e gazrave serrë nga një instalim specifikohen në ndonjë akt tjetër për skemat e tregtimit të lejeve për shkarkimet e gazrave serrë për çdo veprimtari që kryhet në atë instalim, dhe nëse nuk është e nevojshme të sigurohet që nuk do të shkaktohet ndotje e konsiderueshme e mjedisit. Dispozitat e kësaj pike nuk zbatohen mbi instalimet që përjashtohen përkohësisht nga kjo skemë.
 4. Leja e mjedisit e tipit A mund të përmbajë edhe kushte të tjera sic kërkohet nga akte të tjera në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në tërësi. Në asnjë rast këto kushte nuk duhet të bien ndesh me kërkesat e këtij ligji, po që se nuk parashikohet ndryshe prej tij.

Neni 11

Kërkesa për leje mjedisi të tipit A

1. Kërkesa me shkrim për leje mjedisi të tipit A, e percaktuar në pikën 7 të këtij neni, i paraqitet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 48 të këtij ligji, dhe përmban:
 - (a) Emrin, adresën, dhe numrin e telefonit të kerkuesit, dhe adresën ku duhet të dërgohet korrespondenca lidhur me këtë kerkese, nëse kjo është e ndryshme nga adresa e kerkuesit;
 - (b) Adresën e vend-ndodhjes së instalimit;
 - (c) Një hartë ose një skicë që tregon vend-ndodhjen dhe pozicionimin e instalimit në atë vend-ndodhje;
 - (d) Emrin e bashkisë ose të komunës ku gjendet vend-ndodhja e instalimit;
 - (e) Përshkrimin e instalimit dhe të veprimtarive që do të kryhen në instalim, dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me to dhe që do të kryhet në të njëjten vend-ndodhje me këtë instalim dhe do të ketë një lidhje

teknike me veprimtarite e permendura fillimisht dhe qe mund te ketë një ndikim ne shkarkimet e instalimit dhe ndotjen e prodhuar prej tij;

- (f) Raport mbi kushtet e vend-ndodhjes se instalimit që identifikon ne mënyrë të vecantë çdo substance qe ndodhet mbi, në ose nën toke qe mund te përbëjë rrezik për ndotje;
 - (g) Skemat me rradhën e proceseve te prodhimit qe synohet te përdoren;
 - (h) Informacion mbi lendet e para dhe materialet ndihmese, duke përfshirë dhe ujin, substanca të tjera dhe energji qe do të përdoret ose gjenerohet nga instalimi;
 - (i) Informacion mbi natyrën, sasinë dhe burimet e shkarkimeve nga instalimi ne të gjithë përbërësit e mjedisit, si dhe identifikimin dhe përshkrimin e çdo efekti te rëndësishëm te shkarkimeve ne mjedis;
 - (j) Informacion mbi teknologjinë e propozuar dhe teknika te tjera për parandalimin, ose kur kjo nuk është e mundur, pakësimin e shkarkimeve nga instalimi;
 - (k) Informacion mbi masat e propozuara dhe metodat qe do të zbatohen për monitorimin e shkarkimeve të instalimit;
 - (l) Përshkrimin e masave qe do të ndërmerren për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve te gjeneruara nga instalimi, kur është e nevojshme;
 - (m) Përshkrimin e masave te tjera te propozuara për tu ndërmarrë për të përmbushur parimet e pergjithshme të përcaktuara ne nenin 9 te ketij ligji;
 - (n) Alternativat kryesore te metodave dhe teknikave të prodhimit, nqse ekzistojnë, që kerkuesi i ka studiuar;
 - (o) Çdo informacion tjetër qe kerkuesi i lejes dëshiron qe te mbahet parasysh kur shqyrtohet kerkesa; dhe
 - (p) Përmbledhje jo-teknike të informacionit te referuar ne germat e mesiperme te pikes 1 te ketij neni.
2. Kerkesa për lejen e mjedisit te tipit A përfshin edhe çdo informacion te rëndësishëm te përftuar ose konkluzionet e arritura ne lidhje me instalimin nga Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis, ne rastet kur per funksionimin e tij kërkohet një Raport i Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis ne përputhje me ligjin për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis.
3. Ne rastet kur per funksionimin e një instalimi kërkohet përgatitja e një Raporti mbi Sigurinë ne përputhje me ligjin per Parandalimin e Rreziqeve te Medha nga Aksidentet, raporti mbi Sigurinë mund te përfshihet ose t'i bashkëngjitet kerkeses për lejen e mjedisit te tipit A.

4. Sipas rastit, kërkesa për leje mjedisi e tipit A për një instalim ekzistues shoqërohet me:
 - (a) një kopje të lejes së ujit të dhënë për këtë instalim në përputhje me ligjin për rezervat ujore;
 - (b) një kopje e Licences për Menaxhimin e Mbetjeve të dhënë për këtë instalim në përputhje me ligjin për administrimin mjedisor të mbetjeve;
 - (c) një kopje të lejes për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme të dhënë për këtë instalim në përputhje me ligjin për administrimin e mbetjeve të rrezikshme;
 - (d) një kopje të çdo leje mjedisi apo autorizimi mjedisor ekzistues të dhënë për këtë instalim; dhe
 - (e) një kopje të Lejes së Zhvillimit, Ndërtimit ose Përdorimit të dhënë për këtë instalim, siç parashikohet nga legjislacioni për Planifikimin e Territorit në Republikën e Shqipërisë.
5. Kerkuesi paraqet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën origjinale për një leje mjedisi të tipit A, të firmosur, dhe tetë (8) kopje të kësaj kërkesë.
6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit e konsideron kërkesën për leje mjedisi të tipit A si të vlefshme, vetëm kur kerkuesi ka kryer ose provon që ka kryer pagesën e tarifës që parashikohet në nenin 49 të këtij ligji. Kërkesa për leje mjedisi të tipit A nuk konsiderohet si e kryer nëse nuk shoqërohet nga dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse..
7. Ministri miraton formularin standard të kërkesës për leje mjedisi të tipit A, i cili hyn në fuqi mbas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 12

Shqyrtimi i kërkesës për leje mjedisi të tipit A

1. Pas marrjes së kërkesës për leje mjedisi të tipit A sipas përcaktimit në nenin 11, Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton menjëherë me shkrim kerkuesin për marrjen në rregull të kërkesës.
2. Brenda 14 ditëve nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit A, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, dërgon një kopje të kërkesës në:
 - (a) bashkinë ose komunën, në territorin e së cilës ndodhet instalimi;
 - (b) Këshillin e Qarkut;
 - (c) Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit;

- (d) Agjencinë e basenit ujëmbledhës të lumit pranë të cilit është vendndodhja e instalimit;
 - (e) Ndërmarrjen përkatëse të ujëesjellës kanalizimeve, në rast se në atë rrjet kanalizimesh mund të shkarkohet ndonjë substancë si rezultat i funksionimit të instalimit;
 - (f) Administratën e Zonës Natyrore të Mbrojtur kur funksionimi i instalimit mund të shkaktojë një shkarkim që mund të ndikojë në atë zonë.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit A, nëse e konsideron të nevojshme kërkon me shkrim nga kerkuesi i lejes informacione të tjera shtese. Kërkesa e saj specifikon arsyen ose arsyet përse kërkohet ky informacion shtesë.
 4. Kerkuesi, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit informacionin shtesë të kërkuar në pikën 3, të këtij neni. Kerkuesi i lejes së mjedisit të tipit A dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mund të zgjatën këtë periudhë 30 ditore me një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
 5. Nëse kerkuesi i lejes së mjedisit të tipit A nuk dërgon informacionin shtesë të kërkuar sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij neni brenda periudhës së kohës sipas përcaktimit të pikës 4 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit vlerëson që kerkuesi i lejes së mjedisit të tipit A, ka tërhequr vetë kërkesën dhe e informon kerkuesin me shkrim për këtë vlerësim.
 6. Pas marrjes së informacionit shtesë sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ia dërgon menjëherë atë autoriteteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.
 7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe autoritetet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, brenda 45 ditësh nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit A nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, mund të inspektojnë instalimin dhe/ose vendndodhjen e tij me qëllim verifikimin e informacionit të dhënë nga kerkuesi i lejes.
 8. Autoritetet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, në përputhje me fushën e kompetencave të tyre, brenda 45 ditësh pas periudhës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, ose periudhës së përcaktuar në pikën 6 të këtij neni kur është inspektuar instalimi dhe/ose vendndodhja e tij me qëllim verifikimin e informacionit të dhënë nga kerkuesi i lejes i japin Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me shkrim ose në rrugë elektronike, komentet për kërkesën për leje mjedisi të tipit A nga subjekti i interesuar. Kur një nga autoritetet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nuk dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda këtij afati, asnjë koment mbi kërkesën për leje mjedisi të tipit A nga subjekti i interesuar, konsiderohet se ai autoritet nuk ka komente për këtë kërkesë.

Neni 13

Njoftimi publik për kërkesen për leje mjedisi te tipit A

1. Kerkuesi i lejes se mjedisit te tipit A, ne perputhje me nenin 45 te ketij ligji, brenda periudhes prej 14 ditesh nga paraqitja e kerkeses per leje dhe kur kjo kerkese eshte gjykuar e vlefshme sipas percaktimit te nenit 11 te ketij ligji, publikon nje njoftim per kete kerkese, ne te paktën ne një prej gazetave lokale te perditshme te zones ku ndodhet instalimi dhe në një nga gazetave kombëtare te perditshme,. Njoftimi publikohet në të paktën dy botime te njëpasnjëshëm të secilës gazetë.
2. Kerkuesi i dergon nga nje kopje te njoftimeve te percaktuar ne piken 1 te ketij neni, Agjencisë Kombetare te Mjedisit, e cila e vendos kete njoftim ne faqen e vet te internetit.
3. Njoftimi sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni tregon:
 - (a) Nëse kërkesa është për një leje të re mjedisi te tipit A apo për një rishikim të lejes ekzistuese te tipit A apo kushteve të saj;
 - (b) emrin e kerkuesit;
 - (c) adresën e vend-ndodhjes se instalimit;
 - (d) nje përshkrim te shkurtër të veprimtarise ose veprimtarive qe parashikohet te zhvillohen ne instalim;
 - (e) se përmban një përshkrim të elementëve të renditur në nenin 11.1;
 - (f) sipas rastit se kërkesa është subjekt i një Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis në nivel kombëtar apo ndërkufitar, në përputhje me ligjin “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
 - (g) sipas rastit nëse kërkesa eshte subjekt i konsultimeve ndërkufitare;
 - (h) që Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për vendimin që merret për atë kërkesë dhe sqaron cilat janë vendimet e mundshme për këtë kërkesë dhe qe të gjitha mundësitë janë të hapura;
 - (i) sipas rastit, detajet në lidhje me rishikimin dhe përditësimin e lejes apo kushteve të saj;
 - (j) se ku dhe si mund te shqyrtohet kërkesa dhe informacione te tjera të vlefshme përfshirë raportin kryesor dhe nëse ndonjë informacion tjetër mund të shqyrtohet, kohen kur është e disponueshme për tu shqyrtuar dhe qe mund të shqyrtohet pa pagesë;
 - (k) që çdo person fizik apo juridik i interesuar per te shprehur mendimin e tij mbi kërkesen per leje mjedisi te tipit A ose të bëjë pyetje mbikëte kërkesë,

mund ta bëjë këtë duke kontaktuar Agjencinë Kombëtare e Mjedisit, me shkrim ose ne menyre elektronike brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Njoftimi tregon edhe adresën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ku mund të dërgohen mendimet.

Neni 14

Konsultimi publik për kërkesën për leje mjedisi të tipit A

1. Njësia e qeverisjes vendore (bashkia apo komuna) në territorin e se cilës ndodhet instalimi për të cilin është kërkuar leje mjedisi e tipit A, në përputhje me përcaktimin e nenit 45 të këtij ligji, sapo merr një kopje të aplikimit për leje mjedisi të tipit A të njëjtë me atë që gjendet në regjistrin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, e vë atë menjëherë në dispozicion të antarëve të publikut në zyrat e bashkisë apo komunës gjatë orarit zyrtar normal.
2. Çdo person fizik apo juridik ka të drejte të shqyrtojë dokumentacionin e kërkesës për leje mjedisi të tipit A në zyrat e bashkisë apo komunës përkatëse pa pagesë.
3. Çdo person fizik apo juridik ka të drejte të marrë kopje të kërkesës për leje mjedisi të tipit A, nga zyrat e bashkisë apo komunës kundrejt pagesës që mund t'i kërkohej nga ajo zyrë për mbulimin e kostos së fotokopjimit.
4. Çdo person fizik apo juridik ka të drejte të japë mendim për kërkesën për leje mjedisi të tipit A. Komentet jepen me shkrim ose në mënyrë elektronike në adresë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
5. Çdo mendim i dhënë mbi kërkesën për një leje mjedisi të tipit A, sipas pikës 4 të këtij neni, i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda 30 ditëve nga njoftimi, sipas përcaktimit të Nenit 13, pika 1, e këtij ligji.
6. Kërkuarësit të lejes së mjedisit të tipit A, kur i kërkohej të publikojë një njoftim sipas përcaktimit të Nenit 13 të këtij ligji dhe një njoftim sipas përcaktimit të **Nenit 26 të Ligjit Nr. _____, datë _____ “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”**, ai lejohet të zgjedhë të publikojë një njoftim të vetëm që plotëson njëkohësisht kërkesat e të dy ligjeve.

Neni 15

Vendimi mbi kërkesën për një leje mjedisi të tipit A

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos të japë lejen e mjedisit të tipit A për një instalim duke vendosur kushte në përputhje me Nenin 9 dhe 10 të këtij ligji. ose vendos të refuzojë dhënien e kësaj leje.
2. Ministri miraton formularin standard të vendimit të miratimit apo refuzimit të kërkesës për leje mjedisi të tipit A.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjate marrjes se vendimit sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, merr parasysh:
 - (a) mendimet e marra brenda periudhës se lejuar nga autoritetet perkatese sipas percaktimit te Nenit 12, pika 8, te ketij ligji;
 - (b) mendimet e marra brenda periudhës se lejuar, nga cdo përfaqësues i publikut sipas percaktimit te Nenit 14, pika 4 te ketij ligji; dhe
 - (c) kur eshte e nevojshme, informacionet ose përfundimin e nxjerrë për atë instalim nga Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis i kryer për të ne zbatim te ligjit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis,.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr vendimin sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni brenda nëntë muajve nga data e informimit te kerkuesit që kërkesa për leje mjedisi te tipit A është marrë në rregull sipas percaktimit te nenit 12 te ketij ligji.
5. Periudha kohore sipas percaktimit te pikes 4 te ketij neni mund te zgjatet për aq kohe sa Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe kerkuesi bien dakord me shkrim, por ne asnje rast ajo nuk mund te zgjatet me më shume se katër muaj të tjera.
6. Periudha kohore prej nëntë muajsh per marrjen vendimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, sipas percaktimit te pikes 4 te ketij neni, nuk e përfshin kohën që fillon nga data e kërkesës për informacion shtesë sipas percaktimit te nenit 12, pika 3 e ketij ligji dhe që përfundon në datën kur kerkuesi ja siguron këtë informacion të kërkuar.
7. Kerkuesi, në rastin kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk merr vendim mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit A brenda afatit te percaktuar sipas pikes 4 dhe 5 te ketij neni, mund te ankimoje mos marrjen e ketij vendimi sipas percaktimit te Kodit te Procedurave Administrative.
8. Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon kerkuesin dhe Qendrën Kombëtare te Licencimit për vendimin e vet, sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, me shkrim brenda pese ditëve nga marrja e vendimit. Vendimi i refuzimit te kerkeses për leje mjedisi te tipit A permban te gjitha shkaqet për refuzimin.
9. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastin kur vendos të miratojë kerkesen per leje mjedisi te tipit A, i dërgon Qendrës Kombëtare te Licencimit një kopje te lejes ne forme elektronike dhe kerkuesit nje kopje të lejes.
10. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, vendos një kopje të vendimit dhe lejes përfshirë kushtet e lejes, nëse është e nevojshme, në regjistrin e referuar në nenin 45. sipas rastit, regjistri përfshin të gjitha përditësimet që i bëhen lejes apo kushteve të saj.
11. Agjencia Kombetare e Mjedisit, publikon ne rregjistrin e percaktuar ne nenin 45 te ketij ligji deklaratën e vet se ka shqyrtuar shqetësimet dhe komentet e

ngritura nga publiku, informacionet perkatese mbi procesin e konsultimit publik si dhe arsyet apo konsideratat mbi te cilat është bazuar vendimi.

12. Agjencia Kombetare e Mjedisit, brenda tre ditësh nga marrja e vendimit sipas pikës 1 të këtij neni, i dërgon bashkisë ose komunës përkatëse, një kopje të informacionit të përcaktuar në pikat 10 dhe 11.

Seksioni 3

Ndryshime ne funksionim

Neni 16

Ndryshim i propozuar ne funksionimin e një instalimi te tipit A

1. Operatori i një instalimi te tipit A, kur planifikon te kryeje një ndryshim ne funksionimin e këtij instalimi, njofton Agjencinë Kombëtare e Mjedisit te paktën 14 dite përpara kryerjes se ketij ndryshimi.
2. Njoftimi sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, behet me shkrim dhe përmban një përshkrim te ndryshimit te propozuar ne funksionimin e instalimit.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda pese diteve nga marrja e njoftimit sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, lajmëron me shkrim operatorin për marrjen e njoftimit.
4. Agjencia Kombetare e Mjedisit, nqse është e nevojshme përditëson lejen e mjedisit të tipit A ose kushtet e saj.
5. Agjencia Kombetare e Mjedisit, kur vendos të përditësojë lejen e mjedisit të tipit A ose kushtet e saj, njofton me shkrim operatorin duke specifikuar përditësimin e lejes dhe datën apo datat kur ky përditësim bëhet I vlefshëm. Agjencia Kombetare e Mjedisit në të njëjtën kohë njofton elektronikisht Qendrën Kombëtare të Licencimit dhe vendos një kopje të lejes së përditësuar të tipit A në regjistrin e referuar në nenin 45.

Neni 17

Ndryshim thelbesor i propozuar ne funksionimin e një instalimi te tipit A

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlereson se ndryshimi i propozuar nga operatori ne funksionimin e një instalimi te tipit A, sipas njoftimit te bere ne zbatim te nenit 16 te ketij ligji, mund te shkaktoje një ndryshim thelbesor te funksionimit te instalimit, informon operatorin se duhet te kerkoje një ndryshim ne kushtet e lejes se tipit A, në mënyrë që instalimi të vazhdojë të funksionojë mbas ketij ndryshimi.
2. Dispozitat e Neneve nga 11 deri 15 te ketij ligji zbatohen edhe për kerkesen per ndryshim te kushteve te lejes se mjedisit te tipit A. Ne zbatim te ketij neni

fjalët “kerkese për një leje mjedisi te tipit A” lexohen “kerkese për një ndryshim ne kushtet e lejes se mjedisit te tipit A”.

3. Kerkesa per ndryshim te kushteve te lejes se mjedisit te tipit A, behet per ato pjese te instalimit qe mund te ndikohen nga ndryshimet e propozuara dhe për ato aspekte te nenit 11 te ketij ligji që mund të ndikohen nga ndryshimi i propozuar.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vendos te ndryshoje kushtet e një leje mjedisi te tipit A, njofton me shkrim operatorin duke specifikuar ndryshimet ne kushtet e lejes dhe datën ose datat kur këto ndryshime bëhen te vlefshme. Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon në të njëjtën kohë ne rruge elektronike edhe Qendrën Kombëtare te Licencimit dhe vendos një kopje të lejes së përditësuar të tipit A në regjistrin e referuar në nenin 45.
5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vlereson nje kerkese për ndryshim ne kushtet e lejes se mjedisi te tipit A si te vlefshme vetëm kur kerkuesi ka paguar ose provon qe ka paguar tarifen sipas percaktimit te nenit 49 te ketij ligji. Kerkesa për ndryshim ne kushtet e lejes se mjedisi te tipit A nuk konsiderohet si e kryer nëse nuk shoqërohet nga dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës perkatese.

Neni 18

Rishikimi dhe perditesimi i kushteve te lejes se mjedisit te tipit A

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit rishikon periodikisht dhe te paktën një here ne shtate vjet, kushtet e lejeve te mjedisit te tipit A.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur si rezultat i rishikimit te kryer sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni vlereson se kushtet e lejes se mjedisit te tipit A duhen perditesuar, i perditeson ato dhe njofton me shkrim dhe ne rruge elektronike perkatesisht operatorin dhe Qendrën Kombëtare te Licencimit.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pervec sa percaktohet ne piken 1 te ketij neni, kryen një rishikim te lejes se mjedisit te tipit A dhe, nëse është e nevojshme perditeson kushtet e kësaj leje kur:
 - (a) ndotja e shkaktuar nga instalimi per funksionimin e te cilit eshte dhene leje mjedisi e tipit A është aq e madhe sa që bën të nevojshëm rishikimin e vlerave kufi ekzistuese te shkarkimeve për lejen e mjedisit te tipit A ose përfshirjen e vlerave te reja kufi për keto shkarkime;
 - (b) ndryshimet thelbesore ne teknikat me te mira te disponueshme bëjnë te mundur pakësimin e shkarkimeve nga instalimet pa shkaktuar kosto te tepërta;
 - (c) funksionimi i sigurt i proceseve ose veprimtarive qe kryhen ne instalim kërkon përdorimin e teknikave te tjera;

- (d) kërkohet nga legjislacioni ne fuqi.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastin e situatës së përcaktuar në pikën 3(a) informon operatorin mbi nevojën për zbatimin e një ndryshimi në kushtet e lejes në mënyrë që instalimi të vazhdojë funksionimin pasi të ketë ndodhur ky ndryshim.
 5. Dispozitat e nenit 11 deri 15 zbatohen edhe ndaj kërkesëa për ndryshimin e kushteve të lejes kështu që me “kërkesë për leje mjedisi të tipit A” në këtë rast lexohen “kërkesë për një ndryshim në lejen e mjedisit të tipit A”.
 6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vendos të përditësojë lejen e mjedisit të tipit A apo kushtet e saj, njofton me shkrim operatorin dhe duke sqaruar përditësimin që po i bën lejes si dhe datën apo datat kur ky përditësim behet i vlefshëm. Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton njekohësisht në rrugë elektronike Qendrën Kombëtare të Licencimit dhe vendos një kopje të lejes së tipit A të përditësuar në regjistrin e referuar në nenin 45.

Seksioni 4.

Kërkesa shtese për impjantet e medha me diegie

Neni 19

Fusha e zbatimit e seksionit 4

1. Ky seksion zbatohet për impjantet me djegie, fuqia termike e te cilëve është e barabarte ose me e madhe se 50 MË, pavarësisht nga lloji i karburantit te përdorur (i ngurte, i lëngshëm ose i gazte), ne perputhje me percaktimin e pikes 2 te ketij neni.
2. Ky seksion zbatohet vetëm për impjantet me djegie te projektuar për prodhimin e energjisë me përjashtim te atyre qe përdorin ne mënyrë te drejtperdrejte produktet e djegies ne procesin e prodhimit. Ky seksion nuk zbatohet për:
 - (a) impjantet ne te cilat produktet e djegies përdoren për ngrohjen, tharjen, ose çdo lloj tjetër trajtimi të drejtpërdrejtë të objekteve ose materialeve, si psh. rinxehjen e furnnaltave, furnnaltat për trajtime me nxehtësi;
 - (b) impjantet pas djegies, te tilla si aparaturat teknike te projektuar për te pastruar gazrat e mbetura nepermjet djegies, te cilat nuk funksionojne si një impjantet me djegie i pavarur;
 - (c) impjantet per rigjenerimin e katalizatorëve te krekingut katalitik;
 - (d) impjantet për konvertimin e sulfurit te hidrogjenit ne squfur;

- (e) reaktorët e përdorur ne industrinë kimike;
 - (f) furrat e prodhimit te koksit;
 - (g) furrat me tulla refraktare për prodhimin e gazit të nxehtë (coëpers);
 - (h) aparaturat teknike që përdoren për lëvizjen e automjeteve, anijeve ose avjonëve;
 - (i) turbinat e gazit qe përdoren ne platformat ne det;
 - (j) turbinat e gazit per funksionimin e te cilave eshte marre leje para dates [27 nentor 2002- *date e Direktives. Data e ligjit per tu vendosur nga Ministria*].
 - (k) çdo impjant qe funksionon me motore te ushqyer me benzine, nafte ose gaz.
3. Ne rastin kur dy ose me shume impjante te reja me djegie instalohen ne mënyrë te tille, që sipas vleresimit te Agjencisë Kombetare te Mjedisit që merr parasysh faktoret teknike dhe ekonomike te tyre, mbetjet e gazta te tyre mund te shkarkohen nga një oxhak i perbashket, kombinimi që përftohet prej tyre konsiderohet si një njësi e vetme.

Neni 20

Programet e pakësimit të shkarkimeve

1. Ministria harton programet për pakësimin e vazhdueshem te shkarkimeve totale vjetore nga impjantet ekzistues me djegie. Këto programe do te përcaktojnë afatet kohore dhe proceduarat që zbatojnë pakësimin e shkarkimeve.
2. Programet e pakësimit të shkarkimeve sigurojnë respektimin e tavaneve të shkarkimeve ose përqindjet e pakësimit te dyoksidit të squfurit dhe oksideve të azotit të përcaktuara në *ligjin nr....dt...."Për Mbrojtjen e Mjedisit"*.
3. Programi i pakësimit të shkarkimeve mund te rishikohet në përputhje me kushtet e reja të krijuara kur një ndryshim i ndjeshem dhe i papritur i kërkesës për energji, i disponibilitetit të disa lëndëve djegëse te caktuara apo instalimeve te caktuara te gjenerimit te energjise krijon vështirësi teknike serioze për zbatimin e tij. Rishikimi mund te përfshijë rishikimin e tavaneve të shkarkimeve ose te datave të vendosura për respektimin e atyre tavaneve te shkarkimeve.
4. Keshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton rregullat e detajuara per hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve te pakësimit të shkarkimeve

Neni 21

Vlerat Kufi te Shkarkimeve

1. Leja e Mjedisit e Tipit A për impjantet e reja me djegie përmban kushte për shkarkimet e dyoksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe pluhurave të cilat nuk janë me pak shtrënguese se vlerat kufi të shkarkimeve të percaktuara në pjesën B të Shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji.
2. Leja e Mjedisit e Tipit A për impjantet ekzistuese me djegie përmban të dhëna mbi Planin e Përputhshmërisë që siguron që brenda datës [1 Janarit 2008 - date e Directives. Data e ligjit për tu vendosur nga Ministria] shkarkimet e dyoksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe pluhurave do të jenë pakësuar deri të paktën në nivelin e vlerave kufi të shkarkimeve të percaktuara në pjesën A të Shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji,

[paragrafi 2 prezumon se Shqipëria nuk do të përgatisë dhe zbatojë një plan kombëtar për shkarkimet (që është mekanizmi alternativ për të zbatuar direktivën përIMD (Impjantet e Medha me Djegie) për IMD – të ekzistues)]

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të perjashtojë një impjant ekzistues me djegie nga detyrimi për përputhshmëri me vlerat kufi të shkarkimeve të percaktuara në pikën 2 të këtij neni, në qoftë se:
 - (a) Operatori i atij impjanti ekzistues me djegie, në marreveshje me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pranon si pjesë të kushteve të Lejes së Mjedisit të tipit A të cilën ai ka kërkuar, të shfrytëzojë impjantin me djegie për jo më shumë se 20.000 ore punë nga data e marreveshjes deri në një datë jo më vonë se data ...(31 December 2015 - date e Directives. Data e ligjit për tu vendosur nga Ministria); dhe
 - (b) Operatori, si kusht të lejes së mjedisit të tipit A, ka detyrimin të paraqesë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si pjesë të raportit të tij vjetor,, një regjistër ku percaktohet koha e përdorur dhe ajo e papërdorur në raport me kohën totale të lejuar për funksionimin e atij impjanti me djegie.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për një impjant me djegie që në kushte normale përdor lëndë djegëse me përmbajtje të ulet squfuri, mund të lejojë pezullimin e detyrimit për respektim të vlerave kufi të shkarkimeve të dyoksidit të squfurit të percaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, në rastet kur:
 - (a) Operatori nuk ka mundësi të respektojë vlerat kufi të shkarkimeve për shkak të ndërprerjes së furnizimit me lëndë djegëse me përmbajtje të ulet squfuri, si pasoje e mungesës objektive të saj në treg, dhe
 - (b) Periudha e pezullimit nuk zgjat më shumë se gjashtë muaj.
5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të lejojë përjashtimin e një impjanti me djegie që në kushte normale përdor vetëm lëndë djegëse të gazta, nga detyrimi

per respektimin e vlerave kufi te shkarkimeve të percaktuara ne piken 1 dhe 2 te ketij neni, në qoftë se:

- (a) ai impiant, në mënyrë përjashtimore dhe vetëm kur për shkak te një ndërprerje te papritur te furnizimit me gaz mund të përdorë, per një periudhe kohe jo me te gjate se 10 dite, lëndë djegëse te tjera që në kushte normale, për të respektuar vlerat kufi të sipërpërmendura, duhej te shoqëroheshin me një impiant pastrimi të mbetjeve të gazta;
 - (b) afati prej 10 ditësh i referuar në pikën 5, gërma (a) të këtij neni mund të zgjatet për shkak të një nevojës madhore për furnizim të vazhdueshëm me energji; dhe
 - (c) Operatori perkates njofton paraprakisht Agjencinë Kombëtare te Mjedisit.
6. Ne rastin e impjanteve me njësi djegie me shume lëndë djegëse vlerat kufi te shkarkimeve vendosen ne përputhje me Shtojcen 8 te ketij ligji.

Neni 22

Mbetjet e gazta

1. Mbetjet e gazta nga impjantet me djegie shkarkohen ne mënyrë te kontrolluar nepermjet një oxhaku.
2. Leja e Mjedisit e Tipit A sipas rastit përmban edhe kushtet e detajuara për shkarkimin e mbetjeve të gazta.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vendos kushtet e percaktuara në piken 2 te ketij neni, siguron që lartësia e oxhakut të përmendur ne piken 1 te ketij neni, te llogaritet ne mënyrë të tillë qe te ruaje shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Neni 23

Keqfunksionimet ose Avaritë

1. Leja e Mjedisit e Tipit A për çdo impjant me djegie përmban kushte ne lidhje me keqfunksionimet ose avaritë e pajisjeve për pakësimin e ndotjes.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ne rast avarie, kur kthimi në funksionimin normal te impjantit nuk është i mundur brenda 24 orëve i kërkon operatorit te impjantit me djegie pakësimin ose ndalimin e operacioneve ose vazhdimin e funksionimit te impjantit me djegie duke përdorur lëndë djegëse më pak ndotëse. Ne asnjë rast, koha e përgjithshme e funksionimit në kushte avarie te një impianti me djegie nuk mund te jetë më shumë se 120 ore në 12 muaj.

3. Operatori njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda 48 oreve nga ndodhja e avarisë.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të lejoje përjashtimin e impjantit me djegie ku ka ndodhur avaria nga kufizimi prej 24 orësh dhe 120 orësh të referuar në pikën 2 të këtij neni, kur vlereson se:
 - (a) Ka një nevojë madhore për furnizim të vazhdueshëm me energji; ose
 - (b) impjanti me djegie ku ka ndodhur avaria do të zëvendësohet brenda një periudhe të kufizuar kohe nga një impjant tjetër me djegie, i cili do të shkaktonte një rritje të përgjithshme të shkarkimeve.

Neni 24

Impjantet me prodhim të kombinuar të energjise elektrike dhe nxehtësisë dhe depozitimi gjeologjik i dioksidit të karbonit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në vlerësimin e kërkesës për Leje Mjedisit të Tipit A për një instalim të ri me djegie shqyrton mundshmërinë teknike dhe ekonomike për realizimin e prodhimit të kombinuar të energjise elektrike dhe nxehtësisë. Kur konfirmohet kjo mundshmëri, instalimet zhvillohen në përputhje me tregun dhe sistemin e shpërndarjes.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vlereson kërkesën për leje mjedisit të tipit A për një impjant me djegie me prodhim nominal energjitik prej 300 MË ose me shumë, të cilit i është dhënë leja e parë e ndërtimit mbas datës 25 Qershor 2009, nëse plotëson kushtet e mëposhtme:
 - (a) Ka në dispozicion vende të pershtatshme për depozitimin e CO₂;
 - (b) Mjetet e transportimit janë teknikisht dhe ekonomikisht të mundshme; dhe
 - (c) Është ekonomikisht dhe teknikisht e mundshme që investimi për kapjen e CO₂ të bëhet në këtë kohë të mëvonshme.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton nëse kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni plotësohen, duke gjykuar në bazë të vlerësimit të bërë nga kërkuuesi në kërkesën për leje mjedisit, si dhe të çdo informacioni tjetër që lidhet në mënyrë të vecantë me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlereson se kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni plotësohen, kërkon që në vend-ndodhjen e atij impjantit të vihet në dispozicion hapësira e nevojshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme për kapjen dhe ngjeshjen e CO₂.

Neni 25

Shtimi i kapacitetit ose ndryshimi thelbesor ne funksionim

1. Vlerat kufi te shkarkimeve të percaktuara ne pjesën B te Shtojcave 3 deri 7 te ketij ligji zbatohen për pjesën të re të impjantit me djegie, kur kapaciteti termik i tij shtohet me te paktën 50 MË. Vlerat kufi të shkarkimeve percaktohen ne raport me kapacitetin termik të të gjithë impjantit me djegie. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet e referuara në Shtojcën 8, pika 2.
2. Agjencia Kombetare e Mjedisit, kur operatori i një impjanti me djegie propozon një ndryshim thelbesor ne funksionimin e tij, vendos ne lejen e mjedisit te tipit A, në përputhje me nenin 17 te ketij ligji, kushte që percaktojne se vlerat kufi për dyoksidin e squfurit, oksidet e azotit dhe pluhurin te jene jo me pak shtrenguese se vlerat kufi te shkarkimeve të percaktuara në shtojcat nga 3 deri 7 te ketij ligji.

Neni 26

Monitorimi

1. Leja e mjedisit e tipit A per nje impjant me djegie përmban kushte qe sigurojnë se operatori i atij impjanti:
 - (a) Monitoron shkarkimet e impjantit me djegie ne përputhje me shtojcen 9 te ketij ligji;
 - (b) Monitoron te gjitha vlerat e tjera për te siguruar respektimin e dispozitave te lejes se mjedisit te tipit A dhe të këtij ligji;
 - (c) Raporton ne Agjencinë Kombëtare te Mjedisit brenda limiteve kohore te arsyeshme, mbi:
 - i. rezultatet e çdo procesi te vazhdueshëm monitorimi,
 - ii. verifikimin e ekzaktesise se çdo pajisje matëse,
 - iii. secilën matje, dhe
 - iv. te gjitha matjet e tjera qe kërkohen ne lejen e mjedisit e tipit A për te siguruar respektimin e dispozitave të lejes së mjedisit te tipit A dhe të këtij ligji.
2. Ne rastet kur kërkohen matje te vazhdueshme te shkarkimeve, vlerat kufi te shkarkimeve sipas percaktimit te pjesës A te shtojcave 3 deri 7 te ketij ligji, konsiderohet se janë respektuar nëse vlerësimi i rezultateve tregon se gjate funksionimit te impjantit ne orët e punës brenda një viti kalendarik, pa marre parasysh periudhat e ndezjes, te fikjes dhe avarite:
 - (a) Asnjë nga vlerat mesatare gjate nje muaji kalendarik, nuk tejkalon vlerat kufi te shkarkimeve; dhe
 - (b) Ne rastet kur për:

- i. Dyoksidin e squfurit dhe pluhurin: 97% e te gjitha vlerave mesatare gjate 48 orëve te punes nuk tejkalojnë 110 % te vlerave kufi te shkarkimeve,
 - ii. oksidet e azotit: 95% e te gjitha vlerave mesatare gjate 48 orëve te punes nuk tejkalojnë 110 % te vlerave kufi te shkarkimeve.
- 3. Ne rastet kur kërkohen vetëm matje jo-te vazhdueshme ose procedura te tjera te veçanta vlerësimi, vlerat kufi te shkarkimeve sipas percaktimit te shtojcave 3 deri 7 te ketij ligji, konsiderohen te respektuara nëse rezultatet e çdo grupi matjesh nuk tejkalojnë vlerat kufi te shkarkimeve.
- 4. Vlerat kufi te shkarkimeve gjate funksionimit te nje impjanti te ri me djegie ne orët e punes brenda një viti kalendarik, pa marre parasysh periudhat e ndezjes, fikjes dhe avarite, konsiderohen te respektuara, nëse:
 - (a) asnjë vlere mesatare ditore e vertetuar nuk tejkalon vlerat e percaktuara ne pjesën B te shtojcave nga 3 deri 7 te ketij ligji, dhe
 - (b) 95 % e te gjitha vlerave mesatare ditore te vertetuara përgjatë një viti nuk tejkalojnë 200 % te vlerave përkatëse sipas percaktimit ne pjesën B te Shtojcave nga 3 deri 7 te ketij ligji,

“vlerat mesatare te validuara” te referuara ne germen (a) dhe (b) te kesaj pike percaktohen ne perputhje me sa parashikon pika 7 e shtojces 9 te ketij ligji.
- 5. Operatori i secilit impjant me djegie raporton çdo vit ne Agjencinë Kombetare te Mjedisit lidhur me secilin impjant në një vend-ndodhje të caktuar:
 - (a) Shkarkimet vjetore totale te SO₂, NO_x dhe pluhurat (si total i grimcave pezull);
 - (b) Sasinë vjetore totale te energjisë se shfrytezuar, ne lidhje me vlerën kalorifike neto, të zbërthyer ne pese kategori lëndësh djegëse: biomase, lëndë të tjera djegëse te ngurta, lëndësh djegëse te lëngshme, gaz natyror, gaze te tjera.
- 6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe perditeson një regjistër qe përmbledh:
 - (a) Informacionin e mbledhur ne perputhje me percaktimet e pikes 5 te ketij neni;
 - (b) te dhenat per çdo periudhe kohe te lejuar, te përdorur ose jo, dhe për jetëgjatësinë funksionale te mbetur të impjantit me djegie.

Kreu 3

Lejet e Mjedisit te Tipit B

Seksioni 1

Kërkesat e përgjithshme për lejet e mjedisit te tipit B

Neni 27

Kerkesat e përgjithshme per funksionimin e lejes se mjedisit te tipit B

1. Impiantet e tipit B nuk funksionojne pas hyrjes ne fuqi te këtij ligji përveç rasteve te kur kjo lejohet nga leja e mjedisit e tipit B, miratuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, ne perputhje me sa parashikohet ne nenin 52 te ketij ligji.
2. E njejta leje mjedisi e tipit B mund te lejoje funksionimin e me shume se një instalimi te te njëjtit operator ne te njëjtin vend. Instalimet e operatorve te ndryshem qe ndodhen ne te njejtin vend dhe instalimet e te njejtit operator qe ndodhen ne vende te ndryshme kerkojne leje te vecanta të tipit A, B apo C, sipas rastit.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk i jep kërkuesit leje mjedisi të tipit B nëse mendon se ky ky nuk do të jetë personi që kontrollon funksionimin e instalimit pas zoterimit se lejes se mjedisit te tipit B ose se ky nuk siguron se instalimi ne fjale do te funksionoje në përputhje me kushtet e percaktuara ne lejen perkatese te mjedisit te tipit B.

Neni 28

Kerkesat specifike per kushtet te lejes se mjedisit te tipit B

1. Leja e mjedisit te tipit B për cdo instalim permбан:
 - (a) Vlerat kufi te shkarkimit te ndotësve, ne menyre te veçante të atyre te listuar ne shtojcen 2 te ketij ligji, qe parashikohen te shkarkohen ne sasi te konsiderueshme nga instalimi, që përcaktohen duke patur parasysh natyrën dhe potencialin e tyre për te transferuar ndotjen nga një perberes i mjedisit ne një tjetër;
 - (b) Vlerat kufi te shkarkimeve që kërkohen ne germen (a), pika 1 e ketij neni, kur është e mundur, mund të zbatohen për grupet e ndotësve dhe jo per ndotës te veçante,;
 - (c) Vlerat kufi te shkarkimeve që përcaktohen në përputhje me germen (a), pika 1 te ketij neni zbatohen ne piken ku shkarkimet dalin nga instalimi, dhe nuk marrin parasysh ndonjë hollim që mund t'i bëhet atyre.. Gjate përcaktimit të vlerave kufi te shkarkimeve në ujë të atij instalimi, merret parasysh efekti që mund të ketë një impjant për trajtimin e ujit, me kusht

që të garantohet i njëjti nivel mbrojtje për mjedisin në tërësi dhe me kusht që një gjë e tillë nuk con në nivele më të larta të ndotjes së mjedisit

- (d) Normat teknike të shkarkimeve të nje instalimi, te caktuara ne perputhje me legjislacionin për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve apo te zhurmave ose akte te tjera normative ne fuqi qe lidhen me mbrojtjen e mjedisit, për qëllime të germes (a), pika 1 e ketij neni, konsiderohen si vlera maksimale kufi te shkarkimeve;
- (e) Kur një normë e cilësisë se mjedisit kërkon që vlerat kufi të shkarkimeve të nje instalimi të jenë me të ulta se ato që janë vendosur sipas percaktimit te germes (d), pika 1 e ketij neni, atëherë vlerat kufi te shkarkimeve te percaktuara sipas gjermës (a) të pikës 1 të këtij neni kërkojnë vlerat kufi më të ulta të shkarkimeve;
- (f) Kur është e përshtatshme, vlerat kufi te shkarkimeve sipas percaktimit te germes (a), pika 1 e ketij neni, mund te shtohen ose zëvendësohen nga parametra te njejte ose matje teknike.

2. Leja e mjedisit e tipit B përfshin gjithashtu kushte që:

- (a) sigurojne se nuk shkaktohet asnjë ndotje e konsiderueshme, ne veçanti me ane te zbatimit te praktikave me te mira;
- (b) sigurojne mbrojtjen tokës, nëse është e nevojshme;
- (c) sigurojne mbrojtjen e ujërave nëntokësore, nëse është e nevojshme;
- (d) sigurojne menaxhimin e përshtatshëm te mbetjeve te gjeneruara nga instalimi, nëse është e nevojshme;
- (e) percaktojne masat qe duhen ndërmarrë për parandalimin e aksidenteve dhe minimizimin e pasojave te tyre, nëse është e nevojshme;
- (f) percaktojne kerkesa te përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve, duke percaktuar metodologjinë dhe frekuencën e matjeve, procedurën e vlerësimit, dhe te sigurojne se zoteruesi i lejes i jep Agjencisë Kombetare te Mjedisit dhe Inspektoratit Kombëtar te Mjedisit te dhënat e kërkuara për te kontrolluar përmbushjen e kushteve te lejes se mjedisit te tipit B;
- (g) kanë të bëjnë me periudhat kur instalimi nuk funksionon normalisht dhe ka një rrezik real që mjedisi të ndikohet gjatë kësaj periudhe. Në mënyrë të vecantë, përfshihen kushte që kane te bejne me fillimin e funksionimit, rrjedhjet e pa kontrolluara, keqfunksionimet, ndalesat e perkohshme dhe ndalimin përfundimtar te veprimtarise;
- (h) percaktojnë hapat qe duhen ndërmarrë përpara vënies ne pune te instalimit;

- (i) përcaktojnë hapat që duhen ndërmarrë pas ndalimit përfundimtar të funksionimit instalimit në mënyrë që të evitohet çdo rrezik ndotje dhe vendi ku ndodhet instalimi të kthehet në gjendje mjedisore të pranueshme;
 - (j) i kërkojnë operatorit të informojë rregullisht Agjencinë Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, mbi të dhënat e monitorimit të shkarkimeve;
 - (k) i kërkojnë operatorit të informojë pa vonesë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, për çdo incident ose aksident që po ndikon ose mund të ndikojë në mjedis; dhe
 - (l) kërkesa të tjera të posaçme që vlerësohen si të nevojshme nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për arritjen e qëllimeve të këtij ligji.
3. Për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B, mund të kërkojnë edhe kushte të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në teresi. Në asnjë rast, këto kushte nuk mund të bien ndesh me kushtet e parashikuara në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në të.

Neni 29

Kërkeses për leje mjedisi të tipit B

1. Kërkesa për një leje mjedisi të tipit B, e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, i paraqitet me shkrim Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 48 të këtij ligji, dhe përmban:
 - (a) Emrin, adresën, dhe numrin e telefonit të kerkuesit, dhe adresën në të cilën duhet të dërgohet korrespondenca në lidhje me këtë kërkesë për leje, nëse kjo është e ndryshme;
 - (b) Adresën e vend-ndodhjes së instalimit;
 - (c) Një hartë ose një skicë që tregon vend-ndodhjen dhe pozicionimin e instalimit në atë vend-ndodhje;
 - (d) Emrin e bashkisë apo të komunës ku gjendet vend-ndodhja e instalimit;
 - (e) Një përshkrim të instalimit dhe të veprimtarive që do të kryhen në të si dhe të çdo veprimtarie tjetër që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me të, në të njëjtin vend ku ndodhet ai instalim, që kanë lidhje teknike me veprimtaritë e përmendura fillimisht dhe që mund të ketë një ndikim mbi shkarkimet dhe ndotjen;
 - (f) Një raport mbi kushtet e vend-ndodhjes së instalimit. Ky raport do të identifikojë në mënyrë të vecantë çdo substancë që ndodhet mbi, në ose nën tokë që mund të përbëjë rrezik për ndotjeje;

- (g) Skemen dhe hapat e proceseve te prodhimit qe synohet te perdoren;
 - (h) Informacion mbi lendet e para dhe materialet ndihmese, duke përfshirë dhe ujin, substanca të tjera dhe energjine qe perdoren ose gjenerohen nga instalimi;
 - (i) Natyrën, sasinë dhe burimet e shkarkimeve nga instalimi ne çdo përbërës të mjedisit, si dhe identifikimin dhe përshkrimin i çdo efekti te konsiderueshëm te shkarkimeve ne mjedis;
 - (j) Teknologjinë e propozuar dhe teknika te tjera për parandalimin ose, kur kjo nuk është e mundur, pakësimin e shkarkimeve nga instalimi;
 - (k) Masat e propozuara dhe metodat qe zbatohen për te monitoruar shkarkimet nga instalimi;
 - (l) Përshkrimin e masave qe do të ndërmerren për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve te gjeneruara nga funksionimi i instalimit;
 - (m) Përshkrimin e çdo mase tjetër qe do të ndërmerret për të respektuar kërkesat e percaktuara në nenin 28 te ketij ligji;
 - (n) Përmbledhje të alternativave kryesore për metodat dhe teknikat e prodhimit, nëse ekzistojnë, të studjuara nga kerkuesi;
 - (o) Çdo informacion tjetër qe kerkuesi i lejes dëshiron qe te merret parasysh kur vleresohet kerkesa; dhe
 - (p) Një përmbledhje jo-teknike të informacionit te referuar ne germat e mesiperme te pikes 1 te ketij neni.
2. Kerkesa për lejen e mjedisit te tipit B përfshin çdo informacion te rëndësishëm te përfutur ose perfundime te arritura ne lidhje me atë instalim nga Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis, kur per instalimin është kërkuar dhe kryer një Raport i Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis ne përputhje me ligjin për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis.
 3. Kerkesa për leje mjedisi te tipit B për një instalim, në rastet kur per funksionimin e tij kërkohet përgatitja e një Raporti për Sigurinë ne përputhje me ligjin per Parandalimin e Rreziqeve te Medha prej Aksidenteve, përfshin ose bashkangjit edhe Raportin për Sigurinë.
 4. Kerkesa për leje mjedisi të tipit B për një instalim ekzistues, ne rastet kur është e zbatueshme, shoqërohet nga:
 - (a) një kopje te lejes se ujit e dhene per kete instalim ne përputhje me ligjin për rezervat ujore;

- (b) një kopje e Licences për Menaxhimin e Mbetjeve të dhëna për këtë instalim në përputhje me ligjin për administrimin mjedisor të mbetjeve;
 - (c) një kopje të lejes për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme të dhënë për këtë instalim në përputhje me ligjin për administrimin e mbetjeve të rrezikshme;
 - (d) një kopje të çdo leje mjedisi apo autorizimi mjedisor të dhëna për këtë instalim; dhe
 - (e) një kopje të Lejes së Zhvillimit, Ndërtimit ose Përdorimit të dhënë për këtë instalim, siç parashikohet nga legjislacioni për Planifikimin e Territorit në Republikën e Shqipërisë.
5. Kerkuesi paraqet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën origjinale për një leje mjedisi të tipit B, të firmosur, dhe katër (4) kopje të kësaj kërkesë.
 6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vlerëson kërkesën për leje mjedisi të tipit B si të vlefshme kur kerkuesi ka paguar ose provon që ka paguar tarifën e percaktuar në nenin 49 të këtij ligji. Kërkesa për leje mjedisi të tipit B nuk konsiderohet si e kryer nëse nuk shoqërohet nga dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës perkatese.
 7. Ministri miraton formularin standard të kërkesës për leje mjedisi të tipit B, i cili hyn në fuqi mbas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 30

Shqyrtimi i kërkesës për leje mjedisi të tipit B

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi merr kërkesën për leje mjedisi të tipit B sipas percaktimit në nenin 29 të këtij ligji, informon menjëherë me shkrim kerkuesin për marrjen në rregull të kërkesës.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 14 ditëve nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit B, dërgon një kopje të kërkesës në:
 - (a) bashkinë ose komunën në territorin e se cilës ndodhet instalimi;
 - (b) Këshillin e Qarkut;
 - (c) Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit;
 - (d) Agjencinë e basenit ujëmbledhës të lumit pranë të cilit është vend-ndodhja e instalimit;
 - (e) Ndërmarrjen përkatëse të ujësjellës kanalizimeve, në rast se në ato rrjet kanalizimesh mund të shkarkohet ndonjë substancë si rezultat i funksionimit të instalimit;

- (f) Administratën e Zonës së Mbrojtur Natyrore kur funksionimi i instalimit mund të shkaktojë një shkarkim që mund të ndikojë në atë zonë.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit B, kërkon me shkrim informacione të tjera shtese, nga kerkuesi i lejes nëse e konsideron këtë të nevojshme. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton në kërkesën e saj arsyen ose arsyet përse kërkohet ky informacion.
 4. Kerkuesi i lejes së mjedisit të tipit B dërgon informacionin shtese në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij neni, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së saj. Kerkuesi i lejes së mjedisit të tipit B dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mund ta zgjatin këtë periudhë 30 ditore me atë kohë sa bëhet dakord me shkrim mes tyre.
 5. Nëse kerkuesi i lejes së mjedisit të tipit B nuk dërgon informacionin shtese të kërkuar sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij neni brenda periudhës së kohës sipas përcaktimit të pikës 4, të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit vlerëson kërkesën për leje mjedisi të tipit B, si të tërhequr nga vete kerkuesi dhe informon kerkuesin me shkrim për këtë vlerësim.
 6. Pas marrjes së informacionit shtese sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ia dërgon menjëherë këtë informacion shtese autoriteteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.
 7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe autoritetet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, mund të inspektojnë instalimin dhe/ose vend-ndodhjen e tij me qëllim verifikimin e informacionit të dhënë nga kerkuesi i lejes, brenda afatit prej 45 ditësh nga marrja e kërkesës për leje mjedisi të tipit B nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni.
 8. Autoritetet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, në përputhje me fushën e kompetencave të tyre, i japin me shkrim ose në rrugë elektronike Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, vlerësimin mbi kërkesën për leje mjedisi të tipit B të kërkuarit, brenda periudhës prej 45 ditësh pas periudhës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, ose periudhës së përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, në rastin kur instalimi dhe/ose vendodhja e tij është inspektuar me qëllim verifikimin e informacionit të dhënë nga kerkuesi i lejes. Kur një autoritet, nuk dërgon në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda këtij afati asnjë koment mbi kërkesën për leje mjedisi të tipit B, konsiderohet sikur ai autoritet nuk ka asnjë koment për këtë kërkesë.

Neni 31

Njoftimi publik për kërkesën për leje mjedisi të tipit B

1. Kerkuesi i lejes së mjedisit të tipit B, brenda periudhës prej 14 ditësh nga paraqitja e kërkesës për leje Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, dhe kur kjo kërkesë është vlerësuar si e vlefshme sipas përcaktimit të nenit 29 të këtij ligji, në përputhje me sa parashikohet në nenin 45 të këtij ligji publikon një njoftim mbi këtë kërkesë, në

te paktën një gazetë të zones ku ndodhet instalimi dhe në një gazetë kombëtare,.Njoftimi publikohet ne të paktën dy numra te njëpasnjëshëm te secilës gazetë.

2. Kerkuesi i lejes se mjedisit te tipit B, dergon nje kopje te njoftimit te percaktuar ne piken 1 te ketij neni Agjencisë Kombetare te Mjedisit, e cila e vendos atë ne faqen e vet të internetit.
3. Njoftimi sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni :
 - (a) Tregon emrin e subjektit kerkues te lejes se mjedisit te tipit B;
 - (b) Tregon adresën e vend-ndodhjes se instalimit;
 - (c) përshkruan shkurtimisht veprimtaritë qe parashikohet te zhvillohen ne instalim;
 - (d) tregon se kërkesa përmban një pershkrim të efekteve te konsiderueshme te shkarkimeve te instalimit ne mjedis;
 - (e) Tregon se ku dhe si mund të shqyrtohet kërkesa dhe cdo informacion tjetër i rëndësishëm apo informacion shtesë dhe se mund të shqyrtohet pa pagese;
 - (f) Tregon që çdo person fizik apo juridik i interesuar per te shprehur mendimin e tij mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit B, mund ta bëjë këtë me shkrim dhe ta dërgojë në Agjencinë Kombëtare te Mjedisit ne rrugë elektronike brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Njoftimi tregon edhe adresën e Agjencisë Kombetare te Mjedisit;

Neni 32

Konsultimi publik mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit B

1. Bashkia ose komuna ne territorin e se cilës ndodhet instalimi per te cilin eshte kerkuar leje mjedisi e tipit B, ne perputhje me percaktimin e nenit 45 te ketij ligji, merr një kopje të kërkesës, të njëjtë me atë që mbahet në regjistrin publik nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Bashkia ose komuna e vë atë menjëherë në dispozicion të cdo antari të publikut në zyrat e veta gjatë kohës normale të punës.
2. Çdo person fizik apo juridik ka te drejte te shqyrtoje dokumentacionin e kerkeses per leje mjedisi te tipit B ne zyrat e bashkise apo komunes perkatese, gjate orarit zyrtar dhe pa pagesë.
3. Çdo person fizik apo juridik ka te drejte te marre kopje te dokumentacionit te kerkeses per leje mjedisi te tipit B nga zyrat e bashkisë ose komunës perkatese kundrejt një pagese qe mbulon shpenzimeve e fotokopjimit.

4. Çdo person fizik apo juridik ka te drejte te jape me shkrim ne mënyrë elektronike Agjencisë Kombëtare te Mjedisit mendimin e tij per kerkesen për një leje mjedisi te tipit B nga subjekti i interesuar.
5. Çdo mendim, sipas percaktimit te pikes 4 te ketij neni, i dergohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit brenda 30 ditëve nga njoftimi në gazetën kombëtare, sipas percaktimit te Nenit 31, pika 1, e ketij ligji.
6. Kërkuesi i lejes së mjedisit, kur i kërkohet të publikojë një njoftim sipas përcaktimit të Nenit 31 të këtij ligji dhe një njoftim sipas përcaktimit të Nenit 26 të Ligjit Nr.____, datë_____ “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, ai mund të zgjedhë të publikojë një njoftim të vetëm të përbashket që plotëson kërkesat e të dy ligjeve.

Neni 33

Vendimi mbi kerkesen për një leje mjedisi te tipit B

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos të japë ose të refuzojë lejen e mjedisit te tipit B per zhvillimin e veprimtarise se nje instalimi ne varesi te permbushjes ose jo te kushteve te percaktuara ne Nenin 28 te ketij ligji.
2. Ministri miraton formularin standard te vendimit te miratimit apo refuzimit të kërkesës për leje mjedisi te tipit B.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjate marrjes se vendimit sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, merr parasysh:
 - (a) Mendimet mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit B, te marra brenda periudhës se lejuar nga autoritetet perkatese sipas percaktimit te Nenit 30, pika 8, te ketij ligji;
 - (b) Mendimet mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit B, te marra brenda periudhës se lejuar, nga cdo person fizik apo juridik sipas percaktimit te Nenit 32, pika 4 te ketij ligji; dhe
 - (c) çdo informacion ose përfundimin e arritur nga Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis i kryer ne lidhje me atë instalim ne zbatim te ligjit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis, kur ky eshte i nevojshem.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr vendimin sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni brenda gjashte muajve nga data kur ka informuar kerkuesin për marrjen në rregull te kerkeses për leje mjedisore te tipit B sipas percaktimit te nenit 30 te ketij ligji.
5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe kerkuesi mund ta zgjasin periudhën kohore sipas percaktimit te pikes 4 te ketij neni për aq kohe sa bien dakord me shkrim mes tyre, por jo më shumë se një periudhë tjetër 2 mujore.

6. Periudha kohore gjashtë mujore per marrjen e vendimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, sipas percaktimit te pikes 4 te ketij neni, nuk përfshin periudhën që fillon në datën kur kërkohet informacioni shtesë ne lidhje me kerkesen per leje mjedisi te tipit B, sipas percaktimit te nenit 30, pika 3 e ketij ligji, dhe që përfundon në datën kur kërkuesi siguron informacionin shtesë të kërkuar.
7. Kerkuesi, kur Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk vendos mbi kerkesen e tij per leje mjedisi te tipit B brenda afatit te percaktuar sipas pikes 4 dhe 5 te ketij neni, mund te ankimoje mos marrjen e ketij vendimi sipas percaktimit të nenit 76 te Kodit te Procedurave Administrative.
8. Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon kerkuesin dhe Qendrën Kombëtare te Licencimit për vendimin e saj, sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, me shkrim brenda pese ditëve nga marrja e vendimit. Vendimi i refuzimit te kerkeses për leje mjedisi te tipit B, permban te gjitha shkaqet për refuzimin.
9. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur miraton kerkesen per leje mjedisi te tipit B, dërgon një kopje ne forme elektronike te lejes ne Qendrën Kombëtare te Licencimit, dhe nje kopje kerkuesit.
10. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, vendos një kopje te vendimit të vet dhe të lejes, përfshirë sipas rastit edhe kushtet e lejes në regjistrin e referuar në nenin 45 te ketij ligji. Sipas rastit regjistri përfshin edhe përditësime të mëvonshme të lejes apo kushteve të saj.
11. Regjistri përmban gjithashtu një deklaratë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ku kjo pohon se ka shqyrtuar shqetësimet dhe komentet e marra nga publiku, jep informacion për procesin e konsultimit publik, dhe arsyet dhe konsideratat mbi të cilat është bazuar vendimi.
12. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit sipas pikës 1 të këtij neni i dërgon bashkise apo komunës përkatëse një kopje të informacionit të përcaktuar në pikat 10 dhe 11

Seksioni 2

Ndryshime ne funksionim

Neni 34

Ndryshim i propozuar ne funksionimin e një instalimi te tipit B

1. Operatori i një instalimi te tipit B, kur planifikon te kryeje një ndryshim ne funksionimin e këtij instalimi, ai njofton Agjencinë Kombëtare te Mjedisit te paktën 14 dite përpara kryerjes se ketij ndryshimi.
2. Njoftimi sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, behet me shkrim dhe përmban një përshkrim te ndryshimit te propozuar ne funksionimin e instalimit.

3. Agjencia Kombëtare te Mjedisit, brenda pese diteve nga marrja e njoftimit sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, lajmëron me shkrim operatorin për marrjen e njoftimit.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nqse është e nevojshme përditëson lejen e mjedisit të tipit B ose kushtet e saj.
5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vendos të përditësojë lejen e mjedisit të tipit B ose kushtet e saj, njofton me shkrim operatorin duke specifikuar përditësimin e lejes si dhe datën apo datat kur përditësimi bëhet i vlefshëm. Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton në të njëjtën kohë në rrugë elektronike Qendrën Kombëtare të Licencimit dhe vendos një kopje të lejes së mjedisit të tipit B të përditësuar në regjistrin e referuar në nenin 45.

Neni 35

Ndryshim thelbesor i propozuar ne funksionimin e një instalimi te tipit B

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlereson se ndryshimi i propozuar nga operatori ne funksionimin e një instalimi te tipit B, sipas njoftimit te bere ne zbatim te nenit 34, pika 1 te ketij ligji, mund te shkaktoje një ndryshim thelbesor në funksionimin e instalimit, informon operatorin se duhet te kerkoje një ndryshim ne kushtet e lejes se tipit B, në mënyrë që instalimi të mund të funksionojë mbas kryerjes së ketij ndryshimi.
2. Dispozitat e Neneve nga 29 deri 33 te ketij ligji zbatohen për kerkesen per ndryshim te kushteve te lejes se mjedisit te tipit B. Ne zbatim te ketij neni fjalët “kerkese për një leje mjedisi te tipit B” lexohen “kerkese për një ndryshim ne kushtet e lejes se mjedisit te tipit B”.
3. Kerkesa per ndryshim te kushteve te lejes se mjedisit te tipit B mbulon ato pjese te instalimit qe mund te ndikohen nga ndryshimet e propozuara dhe ato aspekte të nenit 29 te ketij ligji që mund të ndikohen nga ndryshimi i propozuar.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vendos te ndryshoje kushtet e lejes së mjedisit te tipit B, njofton me shkrim operatorin duke specifikuar ndryshimet ne kushtet e lejes dhe datën ose datat kur këto ndryshime bëhen te vlefshme. Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon në të njëjtën kohë ne rruge elektronike edhe Qendrën Kombëtare te Licencimit, dhe vendos një kopje të lejes së mjedisit të tipit B të përditësuar në regjistrin e referuar në nenin 45.
5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vlereson kerkesen për ndryshim ne kushtet e lejes se mjedisit te tipit B si te vlefshme kur kerkuesi ka paguar ose provon qe ka paguar tarifen sipas percaktimit te nenit 49 te ketij ligji. Kerkesa për ndryshim ne kushtet e lejes se mjedisit te tipit B nuk konsiderohet si e kryer nëse nuk shoqërohet nga dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës perkatese.

Neni 36

Rishikimi dhe perditesimi i kushteve te lejes se mjedisit te tipit B

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit rishikon ne menyre periodike dhe te paktën një here ne shtate vjete, kushtet e lejeve te mjedisit te tipit B.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur si rezultat i rishikimit te kryer sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni vlereson se kushtet e lejes se mjedisit te tipit B duhen perditesuar, i perditeson ato dhe njofton me shkrim dhe ne rruge elektronike perkatesisht operatorin dhe Qendrën Kombëtare te Licencimit.
3. Pervec sa percaktohet ne piken 1 te ketij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit kryen një rishikim te lejes se mjedisit te tipit B dhe, nëse është e nevojshme perditeson kushtet e saj kur:
 - (a) ndotja e shkaktuar nga instalimi per funksionimin e te cilit eshte dhene leje mjedisi e tipit B është aq e madhe sa vlerat kufi ekzistuese te shkarkimeve të përcaktuara në lejen e mjedisit te tipit B duhet te rishikohen ose në atë leje duhen përfshirë vlera te reja kufi për shkarkimet;
 - (b) funksionimi i sigurt i proceseve ose veprimtarive qe kryhen ne instalim kërkon përdorimin e teknikave te tjera;
 - (c) kërkohet nga legjislacioni ne fuqi.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rastin e situatës së përcaktuar në pikën 3(a) informon operatorin mbi nevojën për zbatimin e një ndryshimi në kushtet e lejes në mënyrë që instalimi të vazhdojë funksionimin pasi të ketë ndodhur ky ndryshim.
5. Dispozitat e nenit 29 deri 33 zbatohen edhe ndaj kërkesës për ndryshimin e kushteve të lejes kështu që me “kërkesë për leje mjedisi të tipit B” në këtë rast lexohet “kërkesë për një ndryshim në lejen e mjedisit të tipit B”.
6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vendos të përditësojë lejen e mjedisit të tipit B apo kushtet e saj, njofton me shkrim operatorin dhe duke sqaruar përditësimin që po i bën lejes si dhe datën apo datat kur ky përditësim behet i vlefshëm. Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton njekohësisht në rrugë elektronike Qendrën Kombëtare të Licencimit dhe vendos një kopje të lejes së tipit B të përditësuar në regjistrin e referuar në nenin 45.

Kreu 4

Lejet e mjedisit te tipit C

Neni 37

Kerkesat e përgjithshme per funksionimin e lejes se mjedisit te tipit C

1. Instalimet e tipit C nuk funksionojne pas hyrjes ne fuqi te këtij ligji përveç rasteve te kur kjo lejohehet nga leja e mjedisit e tipit C, miratuar nga **Autoriteti perkates i Qeverisjes Vendore**, ne perputhje me sa parashikohet ne nenin 53 te ketij ligji.
2. E njejta leje mjedisi e tipit C mund te lejoje funksionimin e me shume se një instalimi te te njëjtit operator ne te njëjtin vend. Instalimet e operatorve te ndryshem qe ndodhen ne te njëjtin vend dhe instalimet e te njëjtit operator qe ndodhen ne vende te ndryshme kerkojne leje te vecanta te tipit C.
3. **Autoriteti perkates i Qeverisjes Vendore** nuk i jep kërkuesit leje mjedisi te tipit C nëse mendon se ky nuk do të jetë personi që kontrollon funksionimin e instalimit pas zoterimit se lejes se mjedisit te tipit C ose se ky nuk siguron se instalimi ne fjale do te funksionoje në përputhje me kushtet e percaktuara ne lejen perkatese te mjedisit te tipit C.
4. **Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore** i jep kerkuesit një leje mjedisore te tipit C vetëm ne përputhje me kushtet e percaktuara nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nepermjet Agjencisë Rajonale të Mjedisit perkatese.

Neni 38

Kerkesat specifike per percaktimin e kushteve te lejes se mjedisit te tipit C

1. Leja e mjedisit e tipit C për cdo instalim përmban:
 - (a) Vlerat kufi te shkarkimit te ndotësve, ne menyre te veçante ato te listuara ne shtojcen 2 te ketij ligji, qe parashikohen te shkarkohen ne sasi te konsiderueshme nga instalimi. Vlerat kufi te shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo per ndotës te veçante;
 - (b) Kushte, te cilat sigurojne mbrojtjen e tokës nëse është e nevojshme;
 - (c) Kushte, te cilat sigurojne mbrojtjen e ujërave nëntokësore nëse është e nevojshme;
 - (d) Kushte, te cilat sigurojne menaxhimin e përshtatshëm te mbetjeve te gjeneruara nga instalimi nëse është e nevojshme;
 - (e) Kërkesën që operatori të informoje rregullisht Autoritetin perkates te Qeverisjes Vendore, Agjencinë Kombëtare te Mjedisit dhe Inspektoratin Kombëtar te Mjedisit, mbi te dhënat e monitorimit të shkarkimeve nga ai instalim;
 - (f) Kërkesën që operatori të informoje pa vonesë Agjencinë Kombëtare te Mjedisit dhe Inspektoratin Kombëtar te Mjedisit për çdo incident ose aksident qe po ndikon apo mund te ndikojë ndjeshëm mjedisin; dhe
 - (g) kushte te tjera te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit.

Neni 39

Kërkesa për leje mjedisi te tipit C

1. Kërkesa për leje mjedisi te tipit C, e percaktuar ne piken 5 te ketij neni, i paraqitet me shkrim Autoritetit perkates te Qeverisjes Vendore ne perputhje me procedurat e parashikuara ne nenin 48 te ketij ligji, dhe permban:
 - (a) Emrin, adresën, dhe numrin e telefonit te kerkuesit, dhe adresën ne te cilën duhet te dërgohet korrespondenca ne lidhje me këtë kerkese per leje, nëse kjo është e ndryshme;
 - (b) Adresën e vend-ndodhjes se instalimit;
 - (c) Emrin e bashkise ose te komunës ku gjendet vend-ndodhja e instalimit;
 - (d) Një përshkrim te instalimit dhe te veprimtarive qe do te kryhen ne instalim;
 - (e) Natyrën, sasinë dhe burimet e shkarkimeve nga instalimi;
 - (f) Një përshkrim te masave qe ndërmerren për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve te prodhuara nga instalimi, kur është e nevojshme;
 - (g) Një përshkrim te masave qe do te ndërmerren per magazinimin brenda territorit ku eshte vendosur instalimi, te substancave dhe materialeve te rrezikshme kur eshte e zbatueshme; dhe
 - (h) Çdo informacion shtese qe kerkuesi i lejes dëshiron qe te merret parasysh kur vleresohet kerkesa.
2. Autoriteti perkates i Qeverisjes Vendore vlereson kerkesen per leje mjedisi te tipit C si te vlefshme kur kerkuesi ka paguar ose provon qe ka paguar tarifen e percaktuar ne nenin 49 te ketij ligji. Kërkesa për leje mjedisi të tipit C nuk konsiderohet si e kryer nëse nuk shoqërohet nga dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës perkatese.
3. Ne rastet kur është e zbatueshme, kërkesa për leje mjedisi e tipit C për një instalim ekzistues duhet te shoqërohet nga:
 - (a) një kopje ekzistuese e çdo autorizimi mjedisor, ne lidhje me këtë veprimtari; dhe
 - (b) një kopje e Lejes se Zhvillimit, Ndërtimit ose Përdorimit ne lidhje me këtë instalim, siç parashikohet nga legjislacioni për Planifikimin e Territorit ne Republikën e Shqipërisë.

4. Kerkuesi paraqet ne Autoritetin perkates te Qeverisjes Vendore, kerkesen origjinale për leje mjedisi te tipit C, te firmosur, dhe dy (2) kopje te kësaj kerkese.
5. Ministri miraton formularin standard të kerkeses për leje mjedisi te tipit C, i cili hyn ne fuqi mbas publikimit ne Fletoren Zyrtare.

Neni 40

Shqyrtimi i aplikimit për lejen mjedisore te tipit C

1. Autoriteti perkates i Qeverisjes Vendore, pasi merr kerkesen për leje mjedisi te tipit C sipas percaktimit te nenit 39 te ketij ligji, informon menjëherë me shkrim kerkuesin për për marrjen në rregull të kerkeses.
2. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore, brenda 5 ditëve nga marrja e kerkeses për leje mjedisi te tipit C, dërgon një kopje te kerkeses ne Agjencinë Rajonale te Mjedist dhe Inspektoratit Rajonal te Mjedisit perkates;
3. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore brenda 15 ditëve nga marrja e kerkeses për leje mjedisi te tipit C, nëse e konsideron të nevojshme, kërkon me shkrim nga kerkuesi i lejes informacione te tjera shtese Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore percakton arsyen ose arsyet perse e kërkon këtë informacion.
4. Kerkuesi i lejes se mjedisit te tipit C, dergon informacionin shtese ne Autoritetin përkatës te Qeverisjes Vendore sipas percaktimit te pikes 3, te ketij neni, brenda 15 diteve nga marrja e kerkeses. Kerkuesi i lejes se mjedisit te tipit C dhe Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore, mund te zgjatin këtë periudhe 15 ditore me aq kohë sa bihet dakord me shkrim mes tyre.
5. Nëse kerkuesi i lejes se mjedisit te tipit C nuk dërgon informacionin shtese te kërkuar sipas percaktimit te pikes 3, te ketij neni brenda periudhës se kohës sipas percaktimit te pikes 4, te ketij neni, Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore vlereson kerkesen per leje mjedisi te tipit C, si te tërhequr nga vete kerkuesi dhe informon kerkuesin me shkrim për këtë vleresim.
6. Pas marrjes se informacionit shtese te kërkuar sipas percaktimit te pikes 3 te ketij neni, Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore ia dërgon menjëherë këtë informacion shtese Agjencise Rajonale te Mjedist dhe Inspektoratit Rajonal te Mjedisit perkates.
7. Autoritetet e percaktuara ne piken 2 te ketij neni, ne perputhje me fushen e kompetencave te tyre, i japin me shkrim ose ne rruge elektronike Autoritetit përkatës te Qeverisjes Vendore, mendimin e tyre mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit C, brenda periudhes prej 30 ditësh nga data e percaktuar ne piken 2 te ketij neni. Kur një autoritet, nuk dërgon asnjë koment mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit C ne Autoritetin përkatës te Qeverisjes Vendore brenda këtij afati, konsiderohet sikur ai autoritet nuk ka komente për këtë kerkese

8. Autoriteti i Qeverisjes Vendore përkatëse dhe autoritetet e referuara ne piken 2 te ketij neni mund te vizitojnë vend-ndodhjen e instalimit përpara mbarimit te periudhës 30 ditore te referuar ne piken 7 te ketij neni me qellim verifikimin e informacionit ose informacionit shtese te përfshire ne kerkese.

Neni 41

Vendimi mbi kerkesen për leje mjedisi te tipit C

1. Autoriteti përkatës i Qeverise Vendore vendos të japë lejen e mjedisit te tipit C duke përcaktuar kushte në përputhje me Nenin 38 te ketij ligji ose të refuzojë atë.
2. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore merr vendimin sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni brenda nje (1) muaji nga data kur ka informuar kerkuesin për marrjen në rregull te kerkeses për leje mjedisore te tipit C sipas percaktimit te nenit 39 te ketij ligji.
3. Periudha kohore sipas percaktimit te pike 2 te ketij neni mund te zgjatet për aq kohe sa Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore dhe kerkuesi bien dakord me shkrim mes tyre, por ne asnje rast shtyrja nuk mund te zgjase me shume se nje muaj.
4. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore merr parasysh komentet e marra brenda periudhës se lejuar, nga autoritetet referuar ne Nenin 40 te ketij ligji;
5. Periudha kohore një mujore per marrjen e vendimit nga Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore, sipas percaktimit te pikes 2 te ketij neni nuk përfshin periudhën që fillon në datën kur kërkohet informacioni shtesë sipas percaktimit te nenit 40, pika 3 e ketij ligji dhe përfundon në datën kur kërkuesi siguron informacionin shtesë të kërkuar.
6. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore informon kerkuesin dhe Qendrën Kombëtare te Licencimit për vendimin e vet, sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, me shkrim brenda pese ditëve nga marrja e vendimit. Vendimi i refuzimit te kerkeses për leje mjedisi te tipit C, permban te gjitha shkaqet për refuzimin e tij. Ne rastin kur miraton kerkesen per leje mjedisi te tipit C, Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore, dërgon një kopje ne forme elektronike te lejes ne Qendrën Kombëtare te Licencimit, dhe nje kopje kerkuesit.

Neni 42

Rishikimi dhe perditesimi i kushteve te lejes se mjedisit te tipit C

1. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore rishikon ne menyre periodike dhe te paktën një here ne pese (5) vjete, kushtet e lejes se mjedisit te tipit C. Kur kryen

këte rishikim Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore konsultohet me Agjencinë Rajonale të Mjedisit perkatese.

2. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore, kur si rezultat i rishikimit te kryer sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, vlereson se kushtet e lejes së tipi C duhen perditesuar, i perditeson ato dhe njofton me shkrim dhe ne rruge elektronike perkatesisht operatorin dhe Qendrën Kombëtare te Licencimit.

Kreu 5

Dispozita te Përgjithshme për Lejet e Mjedisit

Neni 43

Efektet mjedisore ndërkufitare ne territorin e një shteti tjetër

1. Ministri i dergon autoritetit kompetent te nje shteti tjetër nje kopje te kerkeses per leje mjedisi te tipit A per funksionimin e nje instalimi, ne rastet kur Ministri informohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit se funksionimi i ketij instalimi ne territorin e Republikës se Shqipërisë ka mundesi reale te krijojë efekte negative te konsiderueshme ne mjedisin e atij shteti, si dhe në rastet kur autoriteti kompetent i një shteti tjetër, qe mund të ndikohet negativisht ne mënyrë te konsiderueshme, e kërkon ate.
2. Informacioni i kerkuar sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, i dergohet autoritetit kompetent te shtetit kerkues në të njëjtën kohë që i dërgohet autoriteteve të përcaktuar ne nenin 12, pika 2 e ketij ligji, ose menjehere nga momenti qe Ministri informohet se funksionimi i ketij instalimi ne territorin e Republikës se Shqipërisë ka mundesi reale te krijojë efekte negative te konsiderueshme ne mjedisin e atij shteti, ose menjëherë pasi i kërkohet nga shteti tjetër.
3. Informacioni sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, shërben si baze për çdo konsultim te nevojshëm ne kuadrin e marrëdhënieve dypaleshe ndermjet Republikës se Shqipërisë dhe shtetit tjetër kerkues te ketij informacioni, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.
4. Ministria brenda pese ditëve informon Agjencinë Kombëtare te Mjedisit per dergimin e nje kopje te kerkeses per leje mjedisi te tipit A per funksionimin e nje instalimi autoritetit kompetent te një shteti tjetër sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon kerkuesin e lejes, mbi kete fakt, brenda pese ditëve ne vijim.
5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk vendos pranimin apo refuzimin e nje kerkese per leje mjedisi te tipit A per funksionimin e nje instalimi derisa Ministria te njoftoje me shkrim ate se konsultimet dypaleshe sipas percaktimit te pikes 3 te ketij neni kane përfunduar dhe se Ministria ka marre një interpretim te autoritetit kompetent te shtetit tjetër mbi kete kerkese brenda afateve, per te cilat eshte rene dakord bashkarisht.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit gjate marrjes se vendimit sipas percaktimit te Nenit 15, pikes 1 e ketij ligji merr ne konsiderate interpretimin e autoritetit kompetent te shtetit tjetër mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit A, sipas percaktimit te pikes 5 te ketij neni.
7. Periudha nënte mujore brenda te cilës merret vendimi mbi kerkesen per leje mjedisi te tipit A sipas percaktimit te nenit 15, pika 4 e ketij ligji fillon te llogaritet nga data ne te cilen Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon kerkuesin e lejes se konsultimet dypaleshe sipas percaktimit te pikes 3 te ketij neni kane përfunduar.

Neni 44

Efektet mjedisore ndërkufitare mbi territorin e Republikës së Shqipërisë

1. Ministri, kur merr dijëni se një instalim i tipit A në territorin e një shteti tjetër mund të ketë efekte negative te konsiderueshme ne mjedis ne territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe nqse nuk e ka marrë ende prej shtetit tjetër një kopje te kerkeses se subjektit te interesuar për leje mjedisi te barazvlefshme me atë te tipit A, ja kërkon atë autoritetit kompetent te atij shteti, së bashku me cdo informacion tjetër që lidhet me te.
2. Informacioni sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, shërben si baze për çdo konsultim te nevojshëm ne kuadrin e marrëdhënieve dypaleshe ndermjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit tjetër, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
3. Ministria brenda pese diteve nga marrja e informacionin sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni ia dergon Agjencise Kombetare te Mjedisit, e cila brenda pese diteve ia dergon atë informacion autoriteteve te referuara ne Nenin 12, pika 2 e ketij ligji.
4. Dispozitat e Neneve 12, 13 dhe 14 te ketij ligji zbatohen për kerkesen për leje mjedisi te barazvlefshme me atë te tipit A, per nje një instalim te vendosur ne territorin e nje shteti tjetër sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, me ndryshimin e vetëm që Agjencia Kombetare e Mjedisit publikon njoftimin sipas percaktimit ne nenin 13 te ketij ligji, ne perputhje me sa eshte rene dakord ndermjet paleve.
5. Ministria i dërgon shtetit tjetër, brenda aq kohe sa është rene dakord ndermjet paleve, çdo koment te bere nga autoritet e referuar ne nenin 12, pika 2 e ketij ligji, ose nga publiku i referuar ne nenin 13 dhe 14 te ketij ligji.

Neni 45

Menaxhimi i informacionit

1. Te gjitha informacionet ne lidhje me instalimet e kategorise A dhe te kategorise B behen publike dhe jane pjese e Sistemit te Informacionit Mjedisor sipas percaktimit te Ligjit “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
2. Autoriteti perkates i Qeverisjes Vendore mban dhe perditeson regjistrin me te dhena mbi instalimet e kategorise C qe ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave te tyre. Ky regjister eshte pjese e Sistemit te Informacionit Mjedisor sipas percaktimit te Ligjit “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
3. Informacioni i referuar në pikat 1 dhe 2 përfshin rezultatet e monitorimit që kërkohen si kusht për lejen përkatëse të atij instalimi.
4. Te dhenat sipas percaktimit te pikes 1 dhe 2 te ketij neni, te cilat konsiderohen si sekret shteteror ne zbatim te ligjit “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” apo jane subjekt i mbrojtjes se legjislacionit ne fuqi per te dhenat personale, te dhenat profesionale apo te dhenat tregtare, nuk behen publike dhe nuk transferohen nga nje autoritet ne nje tjetër sipas percaktimit te ketij ligji pervec rasteve kur parashikohet ndryshe sipas legjislacionit përkatës ne fuqi.

Neni 46

Transferimi i lejeve të mjedisit

1. Per transferimin e lejes perkatese te mjedisit per nje instalim te kategorise A ose B, operatori i ketij instalimi dhe personi fizik apo juridik, te cilit kerkohet t'i tranferohet titulli i lejes, bëjnë një kerkese te përbashkët ne Agjencinë Kombëtare te Mjedisit per kete transferim.
2. Kerkesa sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, shoqërohet nga Leja e mjedisit e tipit A ose e tipit B, sipas rastit, dhe përmban:
 - (a) emrin, adresën dhe numrin e telefonit te operatorit; dhe
 - (b) emrin, adresën dhe numrin e telefonit te personit tjetër fizik apo juridik te referuar ne piken 1 te ketij neni.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit e miraton kerkesën per transferimin e lejes se mjedisit sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, me përjashtim te rastit kur mendon se subjekti tjetër nuk është ai që do të kontrollojë funksionimin e instalimit pas transferimit tek ai të lejes perkatese te mjedisit ose kur subjekti tjetër nuk siguron se instalimi ne fjale do te funksionoje në përputhje me kushtet e percaktuara ne lejen perkatese te mjedisit te transferuar.
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon kerkuesit e transferimit te lejes perkatese te mjedisit dhe Qendrën Kombëtare te Licencimit për vendimin e

vet, sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni, me shkrim brenda pese ditëve nga marrja e vendimit. Vendimi i refuzimit te kerkeses për transferimin e lejes perkatese te mjedisit, permban te gjitha shkaqet për refuzimin.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit miraton transferimin sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni duke nënshkruar lejen e mjedisit te tipit A ose te tipit B sipas rastit, me emrin dhe te dhënat e personit tjetër fizik apo juridik ne titullin e operatorit te instalimit.
6. Transferimi sipas percaktimit te pikes 5 te ketij neni, eshte i vlefshëm nga data per te cilen arrihet nje marreveshje me shkrim ndermjet Agjencisë Kombetare te Mjedisit dhe kerkuesve. Agjencia Kombëtare e Mjedisit i dërgon perkatesisht kerkuesve dhe Qendrës Kombëtare te Licencimit një kopje te shkruar dhe nje kopje ne rruge elektronike te marreveshjes.
7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr vendimin sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni brenda dy muajve nga data e marrjes se kerkeses ose brenda një periudhe me te gjate per te cilen arrihet nje marreveshje me shkrim ndermjet Agjencisë Kombetare te Mjedisit dhe kerkuesve.
8. Kerkesa per transferimin e lejes perkatese te mjedisit te tipit A ose tipit B quhet e refuzuar në fund të afatit te percaktuar sipas pikes 7 te ketij neni nqse Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka marrë një vendim brenda këtij afati.
9. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur e konsideron te nevojshme për vleresimin e kerkeses per transferimin e titullit te lejes perkatese te mjedisit te tipit A ose B, kërkon me shkrim informacion shtese nga operatori i instalimit ose personi tjetër fizik apo juridik referuar ne piken 1 te ketij neni. Kjo kerkesë specifikon arsyen ose arsyet perse kërkohet informacioni shtesë dhe periudhen kohore, brenda te ciles ai duhet te jepet Agjencisë Kombetare te Mjedisit.
10. Kerkesa per transferim sipas percaktimit te pikes 1 te ketij neni konsiderohet si e terhehur nga vete kerkuesit, nqse informacioni shtese sipas percaktimit te pikes 9 te ketij ligji, nuk jepet prej tyre brenda periudhes kohore te percaktuar ne kerkesen perkatese te Agjencise Kombetare te Mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon kërkuesit per kete vendim.
11. Periudha kohore dy mujore e referuar ne piken 7 te ketij neni nuk përfshin periudhën e kohës qe fillon ne datën e dërgimit të njoftimit për informacion shtese sipas percaktimit te pikes 9 te ketij neni dhe mbaron ne datën kur mbërrin informacioni shtese.
12. Dispozitat e pikave nga 1 deri 11 te ketij neni zbatohen edhe për transferimin e lejes se mjedisit te tipit C. Ne zbatim te ketij neni fjalet “leje mjedisi e tipit A ose leje mjedisi e tipit B”, lexohen “leje mjedisi e tipit C” dhe fjalet “ Agjencia Kombëtare e Mjedisit” lexohen “Autoriteti i Qeverisjes Vendore”.

Neni 47

Inspektimi

1. Inspektorati Kombëtar i Mjedisit kryen inspektimet e instalimeve subjekt i këtij ligji në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.
2. Operatori i instalimit mbi të cilin zbatohet ky ligj i jep Inspektoratit Kombëtar të Licencimit gjithë asistencën e nevojshme që ato të mund të kryejnë inspektimet e nevojshme në atë instalim, të marrin mostrat dhe të grumbullojnë gjithë informacionin e nevojshëm për realizimin e detyrave të veta për qëllime të këtij ligji dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Neni 48

Kërkesa procedurale në procesin e kërkesës për leje mjedisi

1. Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës sipas percaktimit të nenit 49 të këtij ligji për leje mjedisi të tipit A dhe B në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit mund të kryhen nëpërmjet:
 - a. paraqitjes drejtpërdrejtë në Agjencinë Rajonale të Mjedisit perkatese sipas vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së kërkuarit;
 - b. dërgimit me postë me lajmërim-marrjeje në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;
 - c. dërgimit me mjete elektronike në përputhje me legjislacionin mbi nënshkrimin elektronik.
2. Kërkesat dhe paraqitja e dokumentit të pagesës së tarifës sipas percaktimit të nenit 49 të këtij ligji për leje mjedisi të tipit C në Autoritetin perkates të Qeverisjes Vendore mund të kryhen nëpërmjet:
 - a. paraqitjes drejtpërdrejtë në Autoritetin perkates të Qeverisjes Vendore sipas vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së kërkuarit;
 - b. dërgimit me postë me lajmërim-marrjeje në Autoritetin perkates të Qeverisjes Vendore;
 - c. dërgimit me mjete elektronike në përputhje me legjislacionin mbi nënshkrimin elektronik kur është e mundur.

Neni 49

Tarifat për lejet e mjedisit

1. Subjekti kerkues i lejes së mjedisit paguan tarifën perkatese për:
 - (a) Kerkese për leje mjedisi të tipit A, B ose C;

- (b) Kerkese për një ndryshim të kushteve të lejes perkatese të mjedisit të tipit A ose të tipit B;
2. Tarifat për lejen e tipit A dhe B i paguhen Agjencise Kombetare të Mjedisit, ndërsa tarifa për lejen e tipit C i paguhet Autoritetit perkates të Qeverisjes Vendore.
 3. Operatori i instalimit i paguan çdo vit një tarifë vjetore, perkatesisht Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për instalimet e tipit A dhe B dhe Autoritetit perkates të Qeverisjes Vendore për instalimet e tipit C.
 4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit miraton vlerat përkatëse të tarifave të përmendura në pikën 1 dhe 3 të këtij neni.
 5. Tarifa dhe vlera përkatëse për lejet e tipit C miratohen nga këshillat perkatese të Qeverisjes Vendore sipas legjislacionit në fuqi dhe në asnjë rast këto vlera nuk mund të kalojnë vlerën e tarifave të percaktuara sipas pikës 4 të këtij neni.
 6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit revokon lejen perkatese të mjedisit të tipit A ose B në rast se operatori i këtij instalimi nuk ka kryer pagimin e tarifës perkatese në zbatim të këtij ligji.
 7. Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore revokon lejen e mjedisit të tipit C në rast se operatori i këtij instalimi nuk ka kryer pagimin e tarifës perkatese në zbatim të këtij ligji.
 8. Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore, informojnë në mënyrë elektronike Qendrën Kombëtare të Licencimit perkatesisht mbi vendimin e revokimit të lejes së mjedisit të tipit A, B ose C.

Neni 50

Heqja dore nga leja e mjedisit

1. Operatori i një veprimtarie subjekt i një leje mjedisi të tipit A, B ose C sipas percaktimit të këtij ligji, mund të bëjë një kerkese për heqjen dore, pjesërisht apo plotësisht, nga leja e mjedisit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit apo Autoritetin përkatës të Qeverisjes Vendore sipas rastit.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo Autoriteti përkatës i Qeverisjes Vendore sipas rastit, miraton heqjen dore pjesërisht apo plotësisht nga leja e mjedisit që kanë dhënë nëse vlerësojnë se operatori ka marrë masat e nevojshme:
 - a. Për të shmangur një rrezik ndotjeje nga veprimtaria e instalimit;
 - b. Për të kthyer territorin e veprimtarisë në gjendje të kënaqshme, duke patur parasysh gjendjen e këtij territori para se instalimi të fillonte veprimtarinë.

Neni 51

Ankimi

1. Çdo palë e interesuar subjekt i këtij ligji, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të Agjencisë Kombëtare të Mjedisitapo njesise perkatese te Qeverisjes Vendore.
2. Ankimi, në të gjitha rastet, paraqitet sipas rastit përmes një kërkesë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit apo Autoritetin perkates te Qeverisjes Vendore, te cilet perkatesisht publikojne ankimin dhe njoftojne në mënyre elektronike Qendrën Kombëtare të Licencimit.
3. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ apo mos veprimit mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 52

Kundravajtjet

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, përbëjnë veprë penale:
 - a. Operatori që i jep informacion fals apo të shtremberuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoratit Kombëtar të Mjedisit, Ministrisë apo cdo autoriteti publik të referuar në këtë ligj, është përgjegjës për veprën penale të parashikuar nga Neni 186 i Kodit Penal;
 - b. Perfaqësuesi i autoritetit publik që i jep informacion fals apo shtremberon, demton, ndalon, fsheh, fshin apo shkatërron të dhëna, fakte apo informacion të mbajtur prej tij, për të cilin publiku ka të drejtën e posedimit, sipas përcaktimit të nenit 13 dhe 31 të këtij ligji, është përgjegjës për veprën penale të parashikuar nga Neni 186 dhe 248 të Kodit Penal;
2. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a. Zhvillimi i veprimtarisë që është subjekt i një lejeje mjedisi të tipit A, B ose C sipas përcaktimit të nenëve 8, 27 dhe 37 të këtij ligji pa lejen perkatese te mjedisit denohet me gjobe ne vleren nga _____ milion leke deri ne _____milion leke duke u shtuar me vleren _____leke cdo dite deri ne plotesimin e detyrimit;

- b. Mos-permbushja dhe mos-respektimi i kerkesave, parimeve dhe kushteve te lejes perkatese se mjedisit te tipit A, B apo C nga operatori i nje instalimi, denohet me gjobe ne vleren nga _____ milion leke deri ne _____milion leke duke u shtuar me vleren _____leke cdo dite deri ne plotesimin e detyrimit;
- c. Mos-informimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga Operatori ne perputhje me percaktimin e nenit 23, pika 3 e ketij ligji, denohet me gjobe ne vleren nga _____ milion leke deri ne _____milion leke, duke u shtuar me vleren _____leke cdo dite deri ne korrigjimin e mos-perputhjes;
3. Informacioni qe i jepet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Autoritetit perkates te Qeverisjes Vendore nga operatori i nje veprimtarie subjekt i ketij ligji nepermjet procesit te vete-monitorimit, mund te perdoret per te vertetuar pergjegjesine penale apo administrative te atij operatorit apo cdo personi tjetër ne nje ceshtje gjyqesore.
4. Pavaresisht nga denimi i parashikuar ne germen “b” dhe “c” te pikes 2 me siper, Agjencia Kombëtare e Mjedisit me propozimin e Inspektoriatit Kombetar te Mjedisit mund te pezulloje apo heqe lejen perkatese mjedisore per te gjithë veprimtarine apo pjese te saj.
5. Inspektorati Kombetar i Mjedisit mund te ndërmarre sanksionet e parashikuara ne këtë nen ne cdo kohe, por jo me vone se pese vite kalendarike nga data e kryerjes se shkeljes.
6. Inspektorati Kombetar i Mjedisit i njofton me shkrim subjektit te shkeljes, aktin e konstatimit dhe vendos sanksionet, brenda 60 dite kalendarike nga momenti qe Inspektorati Kombetar i Mjedisit ben konstatimin e kundravajtjes.
7. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit ne fuqi.
8. Gjoha paguhet brenda një periudhe prej 35 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përvese kur vendimi për dhënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit ne fuqi.
9. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me propozimin e Inspektoriatit Kombetar te Mjedisit, ne rastet kur gjoha nuk eshte paguar brenda afatit te percaktuar ne piken 8 te ketij neni, mund te pezulloje lejen perkatese të mjedisit deri ne pagesen e gjobes.
10. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit, ka të drejtën e ankimit te titullari i strukturës përgjegjëse sipas legjislacionit ne fuqi.

11. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit arkëton dhe administron të ardhurat nga gjobat dhe interesat perkatese, sipas legjislacionit në fuqi.
12. Zbatimi i kundravajtjeve administrative nuk e shmang subjektin perkates nga detyrime te tjera te percaktuara ne kete ligj si dhe pergjegjesia civile per demin e shkaktuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Kreu 6

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 53

Dispozita te përkohshme për instalimet ekzistues te tipit A dhe te tipit B

1. Te gjitha instalimet ekzistuese te tipit A dhe te tipit B do te zbatojnë te gjitha dispozitat e këtij ligji jo me vone se **tete vjet** [kjo është koha që KE i ka lënë vendeve antare për të zbatuar plotësisht direktivën; për tu diskutuar me ministrinë] nga hyrja ne fuqi e ketij ligjit.
2. Operatori i një instalimi ekzistues te tipit A ose te tipit B, brenda dy viteve nga hyrja ne fuqi e këtij ligji i kerkon Agjencisë Kombëtare te Mjedisit paisjen me leje mjedisi te tipit A ose te tipit B, sipas rastit, dhe i paraqet kësaj një Plan Perputhshmërie me kushtet e lejes.
3. Plani i Perputhshmërise me kushtet e lejes perkatese te mjedisit përmban informacionin e nevojshem sipas percaktimit te shtojces 10 te ketij ligji dhe paraqet mënyrën se si operatori siguron zbatimin e dispozitave te pikes 1 te ketij neni.
4. Çdo leje mjedisi e tipit A ose e tipit B, sipas rastit, qe jepet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për operatorin e një instalimi ekzistues merr parasysh Planin e Perputhshmërise me kushtet e lejes për atë instalim, dhe përfshin edhe kete plan te miratuar si pjese përbërëse te asaj leje mjedisi.
5. Lejet e tjera të mjedisit që operatori ka marrë për ate instalim ekzistues sipas përcaktimeve te legjislacionit për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve apo zhurmave ose akte te tjera normative ne fuqi qe lidhen me mbrojtjen e mjedisit, pushojnë efektet e tyre duke filluar nga data kur behet e vlefshme leja e mjedisit te tipit A ose B, sipas rastit, të dhene sipas këtij ligji dhe që rregullon dhe detyron mbi operatorin të njëjtat kushte që janë përfshirë në ndonjë nga ato leje te tjera ekzistuese.
6. Dispozitat sipas percaktimit te pikes 5 te ketij neni nuk zbatohen për lejet për nxjerrjen e ujit, që janë subjekt i legjislacionit për mbrojtjen e ujit, zonat e mbrojtura dhe administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Agjencia Kombëtare e Mjedisit bashkrendon veprimtarine e saj me autoritetet përkatëse për dhënien e lejeve për nxjerrjen e ujit për te siguruar një qasje efektive dhe te integruar te

procesit të dhenies së kësaj lejeje, në veçanti kur merr vendime që lidhen me lejen e mjedisit të tipit A.

Neni 54

Dispozita të përkohshme për instalimet ekzistuese të tipit C

1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C zbatojnë dispozitat përkatëse të këtij ligji jo më vonë se dy vjet nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 55

Dispozita kalimtare për funksione institucionale

1. Funksionet e dhena nga ky ligj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, do të kryhen nga Ministria në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet.
2. Periudha kalimtare sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, perfundon sipas përcaktimit me Udhër të Ministrit, i cili publikohet në “Fletorë Zyrtare”

Neni 56

Raportimi mbi zbatimin e ligjit

1. Ministria publikon një raport mbi zbatimin e këtij ligji brenda datës 30 Tetor 2014 dhe çdo tre vjet për periudhën në vijim.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Autoritetet e Qeverisjes Vendore dhe institucionet e tjera përkatëse i japin Ministrisë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e këtij raporti.
3. Format i Raportit miratohet nga Ministri.
4. Ministria i dorëzon Komisionit Europian pjesën e raportit të miratuar të radhës që trajton zbatimin e këtij ligji lidhur me lejet e tipit A.
5. Dispozita sipas përcaktimit të pikës 4 të këtij neni bëhet efektive me aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Neni 57

Propozimi i akteve nënligjore

1. Ministri propozon aktet nënligjore që miratohen nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.
2. Këshilli i Ministrave dhe ministri, miratojnë aktet nënligjore sipas përcaktimit dhe në zbatim të këtij ligji, brenda një periudhe 2 vjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 58

Aktet Nënligjore

1. Këshilli i Ministrave ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 20 pika 4 dhe 49 pika 3 të këtij ligji.
2. Ministri ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pikat 2 dhe 4, 11 pika 7, 15 pika 2, 29 pika 7, 33 pika 2, 39 pika 5, 55 pika 2 dhe 56 pika 3 të këtij ligji.

Neni 59

Shfuqizime

1. Nenet 34, 36-46 dhe 51/1 të Ligjit Nr. 8934 datë 5.09.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Nenet 31, 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 8093 datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
3. Neni 18 i Ligjit Nr. 9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
4. Nenet 11 dhe 17 të Ligjit Nr. 8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
5. Neni 10 pikat 3, 4, 8 dhe 9, dhe Nenet 13-16, 17 dhe 18 të ligjit Nr. 9537 datë 18.05.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme” shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
6. Neni 25 i Ligjit Nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” nuk zbatohet për veprimtari të cilat rregullohen nga ky ligj, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 60

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Shtojca 1
Lejet e mjedisit te tipit A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi

Lejet e mjedisit te tipit A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vend-ndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht ose jo.

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi per lejet e Tipi A	Kapaciteti kufi per lejet e Tipi B	Kapaciteti kufi per lejet e Tipi C
Industritë energjetike	1.1	Instalimet me djegie	Energjia termike ne hyrje eshte e barabarte ose me e madhe se 50 MW	Inputi (energjia) termike eshte me e vogel se 50 MW	-----
	1.2	Vajrat minerare dhe gazrat e rafinerisë	Te gjitha instalimet	-----	-----
	1.3	Furrat e koksit	Te gjitha instalimet	-----	-----
	1.4	Instalimet e gazifikimit dhe lëngëzimit te qymyrit	Te gjitha instalimet	-----	-----
	1.5	Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror	Te gjitha instalimet	-----	-----
	1.6	Gaz natyror aromatik ose GNL pervec rasteve kur veprimtaria eshte e lidhur me Tipin A, ose përzierje e aromave	-----	Te gjitha instalimet	-----
	1.7	Perzierje aromash per tu përdorur me gazin natyror ose naften e lengeshtuar	-----	Te gjitha instalimet	-----
	1.8	Shpendarja dhe magazinimi i karburantit: a. Magazinimi i naftes ne cisterna te palëvizshme ne ndonje terminal , ose ngarkim/shkarkimi i naftes ne/nga nje cisterne e lëvizshme, cisterne hekurudhore ose anije e ujrave te brendshme ne terminal. b. shkarkimi i naftes ne cisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.	-----	-----	Te gjitha instalimet
	1.9	Furnizimi me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant.	-----	-----	Te gjitha instalimet
Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	2.1	Pjekja ose aglomerimi i xeheroreve metalike (përfshirë xeheroret sulfure)	Te gjitha instalimet	-----	-----
	2.2	Prodhim i gizës ose çelikut (shkriroje primare dhe sekondare) duke perfshire derdhjen e vazhdueshme	Kapaciteti prodhues eshte me i madh se 2.5 ton/ore	Kapaciteti prodhues eshte i barabarte me 2.5 ton/ore ose me i vogel se kaq	-----
	2.3	a. Përpunim i metaleve ferrose – me mullinjtë me rula ne te nxehte	Kapaciteti prodhues eshte me i madh se 20 ton çelik bruto ne ore	Kapaciteti prodhues eshte i barabarte me 20 ton celik bruto ne ore ose me i vogel se kaq	-----
		b. Përpunim i metaleve ferrose - me farketim	Energjia eshte me e madhe se 50 kilojoule per godites, dhe fuqia kalorifike eshte me e madhe se 20	Energjia eshte i barabarte me 50 kilojoule për goditës ose me pak se kaq, dhe fuqia kalorifike eshte e barabarte me 20 MË ose	-----

		c. Përpunim i metaleve ferrose - dhe aplikimi i veshjes me metal te shkrire	MË Furnizimi i procesit me materiale eshte me i madh se 2 ton/ore çelik bruto	me pak se kaq Hyrja eshte e barabarte me 2 ton/ore çelik bruto ose me pak se kaq	-----	
	2.4	Fonderitë e metaleve ferrose	Kapaciteti prodhues eshte me i madh se 20 ton/dite	Kapaciteti prodhues eshte i barabarte me 20 ton/dite ose me pak se kaq	-----	
	2.5	a. Prodhim bruto i metaleve me ngjyre nga xeheroret, nga koncentratet ose lende te para dytësore nga procese metalurgjike, kimike ose elektrolitike	Te gjitha instalimet	-----	-----	
		b. Shkrirja dhe përfitim i aliazheve te metaleve jo-ferrose (me ngjyre) përfshirë produktet e rikuperuara (duke perfshire rafinimin dhe derdhjen ne fonderi)	Kapaciteti shkrirës eshte me i madh se 4 ton/dite për plumbin ose kadmiumin, ose me i madh se 20 ton/dite për te gjitha metalet e tjera	Kapaciteti shkrirës eshte i barabarte me 4 ton/dite për plumbin ose kadmiumin ose me pak se kaq, ose 20 ton/dite për te gjitha metalet e tjera	-----	
	2.6	Trajtime sipërfaqësore te metaleve dhe plastikave duke përdorur procese elektrolitike ose kimike	Volumi i depozites se trajtimit me i madh se 30 m ³	Volumi i depozites se trajtimit eshte i barabarte me 30m ³ ose me pak se kaq	-----	
Industria minerare	3.1	a. Prodhimi i klinkerit te çimentos ne furra rrotulluese	Kapaciteti prodhues eshte me i madh se 500 ton/dite	Kapaciteti prodhues eshte i barabarte me 500 ton/dite ose me pak se kaq	-----	
		b. Prodhim i gëlqeres ne furra rrotulluese	Kapaciteti prodhues eshte me i madh se 50 ton/dite	Kapaciteti prodhues eshte i barabarte me 50 ton/dite ose me pak se kaq	-----	
		c. Prodhim i klinkerit te çimentos ose gëlqeres ne furra te tjera	Kapaciteti prodhues eshte me i madh se 50 ton/dite	Kapaciteti prodhues eshte i barabarte me 50 ton/dite ose me pak se kaq	-----	
			d. Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi ne mase te madhe i cementos ose i klinkerit te çimentos përpara transportimit te tyre ne mase te madhe	-----	-----	Te gjitha instalimet
			e. Perzierja e cementos ose përdorimi i cementos ne mase te madhe por jo ne sheshin e ndertimit, perfshire ambalazhimin dhe përzierjen e cementos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cementos	-----	-----	Te gjitha instalimet
	3.2	a. Prodhim i asbestit ose i produkteve me baze asbesti	Te gjitha instalimet	-----	-----	-----
		b. Prodhim i produkteve me baze asbesti	Te gjitha instalimet	-----	-----	-----
		c. Nxjerrje e asbestit nga mjetet e transportit hekurudhor, me përjashtim te rasteve: (i) gjate riparimit ose mirëmbajtjes se makinerise; (ii) gjate operacioneve te rikuperimit pas nje aksidenti, ose (iii) ne rastet kur asbesti eshte mbuluar pergjithnje me cemento ose ndonje material tjetër (perfshire plastikën, gomen ose rreshiren)	-----	Te gjitha instalimet	-----	-----
		d. shkatërrimi i mjeteve te transportit hekurudhor permes djegies kur asbesti eshte i inkorporuar ose eshte shperndare ne gjithe strukturen e tij.	-----	Te gjitha instalimet	-----	-----
e. Lustrimi industrial duke perfshire gdhendjen, cpimin ose montimin e produkteve te prodhuara prej asbesti, ose		-----	Te gjitha instalimet	-----	-----	

		ndonjërit nga produktet e meposhtme që nuk janë të lidhura me prodhimin – (i) filtrat prej asbesti (ii) produktet e ferkimit prej asbesti (iii) lidhjet, paketimet dhe materialet e perforcimit prej asbesti; (iv) paketimet prej asbesti; (v) tekstilet prej asbesti			
	3.3	Prodhimi i qelqit dhe fibrave të qelqit	Kapaciteti shkrirës është me i madh se 20 ton/dite	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/dite ose më pak se kaq	-----
	3.4	a. Shkrirje e substancave minerare	Kapaciteti shkrirës është me i madh se 20 ton/dite	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/dite ose më pak se kaq	-----
		b. Prodhimi i substancave minerare	Kapaciteti shkrirës është me i madh se 20 ton/dite	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/dite ose më pak se kaq	-----
	3.5	a. Prodhim i produkteve qeramike nepermjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e ocerise/ qeramikes apo të porcelanit	Kapaciteti prodhues është me i madh se 75 ton/dite, dhe/ose kapaciteti i furres është me i madh se 4 m ³ dhe me densitet vendosje që është me i madh se 300 kg/m ³ për çdo furre	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 75 ton/dite ose më pak se kaq, dhe/ose kapaciteti i furrës është i barabartë me 4 m ³ ose më pak se kaq dhe me densitet vendosje për çdo furre që është i barabartë me 300 kg/m ³ ose më pak se kaq	-----
		b. Pjekje e produkteve prej argjile të rende ose produkte zjarr-duruese, përveçse produkteve prej argjile të rende në një furrë ku veprimtaria nuk përfshihet në përshkrimin e kategorisë 3.5 a më lart	-----	Te gjitha instalimet	-----
		c. Llustrim me avull të produkteve prej balte (poceri/qeramike) ose prej argjile me kripera	-----	Te gjitha instalimet	-----
	3.6	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to	-----	Te gjitha instalimet	-----
	3.7	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga gurorët	-----	Te gjitha instalimet	-----
	3.8	Germimet nën ujërat bregdetare ose ujërat sipërfaqesore kontinentale		Te gjitha instalimet	-----
	3.9	Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit	-----	-----	Te gjitha instalimet
	3.10	Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike	-----	-----	Te gjitha instalimet
Industria kimike (1)	4.1	Prodhimi i kimikateve organike baze (2)	Te gjitha instalimet	-----	-----
	4.2	Prodhimi i kimikateve inorganike baze (3)	Te gjitha instalimet	-----	-----
	4.3	Prodhim i pleheruesve me baze fosfori - azoti ose potasiumi (pleherues të thjeshtë apo të perziere).	Te gjitha instalimet	-----	-----
	4.4	Prodhim i produkteve baze për shendetin e bimeve dhe të biocideve.	Te gjitha instalimet	-----	-----
	4.5	Prodhim i produkteve farmaceutike baze me anë të proceseve kimike ose biologjike	Te gjitha instalimet	-----	-----
	4.6	Prodhim i eksploziveve	Te gjitha instalimet	-----	-----

	4.7	Magazinimi i kimikateve, pervecse kur paraqiten si pjese e ndonje veprimtarie tjetere te Tipit A ose Tipit B, dhe pervec ndodhjes ne nje cisterne te levizshme	-----	I barabarte ose me i madh se limitet e mëposhtme: Secili ose disa prej akriloidëve 20 ton; Akrilonitrilet 20 ton; Amoniak anhidrid prej 100 ton; Fluorur hidrogjeni anhidrid 1 ton; Toluen di-isocianati 20 ton; Monomer klorid vinyl 20 ton; Etilene 8000 ton.	Poshte limitit te Tipit B
Menaxhimi i mbetjeve	5.1	a. Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incinerimi	Te gjitha instalimet	-----	-----
		b. Incinerim i mbetjeve duke perfshire mbetjet e kafsheve ne nje instalim incinerimi, pervec atij te referuar ne piken 5.1 a	Instalimi i incinerimit përdoret ose eshte disenjuar per te djegur mbetje me intensitet me shume se 1 ton/ore	Instalimi i incinerimit përdoret ose eshte disenjuar per te djegur mbetje me intensitet te barabarte me 1 ton/ore ose me pak se kaq	-----
	5.2	a. Lendfilli i mbetjeve duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte	Kapaciteti i depozitimit eshte me i madh se 10 ton/dite ose kapaciteti i disenjuar i lendfillit eshte me i madh se 25.000 ton.	Kapaciteti depozitues eshte i barabarte me 10 ton/dite ose me pak se kaq ose kapaciteti i disenjuar i lendfillit eshte 25.000 ton ose me pak se kaq.	-----
		b. Lendfill i mbetjeve inerte	-----	Te gjitha instalimet	-----
	5.3	a. Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a)	Kapaciteti i perpunimit eshte me i madh se 10 ton/dite	Kapaciteti i perpunimit eshte i barabarte me 10 ton/dite ose me pak se kaq	-----
		b. Asgjesimi i vajrave te përdorur pervec incinerimit (5.1 a) ose lendfillimit (5.2.a)	Kapaciteti i perpunimit eshte me i madh se 10 ton/dite	Kapaciteti i perpunimit eshte i barabarte me 10 ton/dite ose me pak se kaq	-----
		c. Asgjesim i mbetjeve jo-te rrezikshme me trajtim biologjik (D8)	Kapaciteti perpunimit eshte me i madh se 10 ton/dite	Kapaciteti perpunimit eshte i barabarte me 50 ton/dite ose me pak se kaq	-----
		d. Asgjesim i mbetjeve jo-te rrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9)	Kapaciteti i përpunimit eshte me i madh se 50 ton/dite	Kapaciteti perpunimit eshte i barabarte me 50 ton/dite ose me pak se kaq	-----
		e. Asgjesimi i mbetjeve jo-te rrezikshme me metoda te tjera pervec (D8) ose (D9)	-----	Te gjitha instalimet	-----
	5.4	a. Rikuperim i mbetjeve te rrezikshme me ane te operacioneve R1, R5, R6, R8, ose R9	Te gjitha instalimet	-----	-----
		b. Rikuperim i mbetjeve te rrezikshme me ane te operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10	-----	Te gjitha instalimet	----
		c. Rikuperim i mbetjeve jo-te rrezikshme	----	Te gjitha instalimet	----
	5.5	Magazinim i hekurishteve/ skrapeve te metalit	-----	Te gjitha instalimet	----
	5.6	a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve te ambalazheve/ paketimeve ose konteniereve ne menyre qe te riperdoren.	-----	Te gjitha instalimet	----
b. Magazinim i mbetjeve ne lidhje me zbatimin e veprimtarive te pikes 5.6 a		-----	Te gjitha instalimet	----	

	5.7	Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve te pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE)	----	Te gjitha instalimet	----
	5.8	Magazinim, rikuperim i hekurishteve ose cmontim i mbetjeve nga motorrat e makinave.	-----	Te gjitha instalimet	-----
	5.9	Magazinim i perkohshem i mbetjeve duke perfshire tepricat e produkteve nga kontejneret ose nga larjet e konteniereve, dhe cdo mbetje te rrezikshme ne mjediset pritese te nje zone portuale dhe ku mbetjet jane magazinuar per jo me shume se 7 dite.	-----	Te gjitha instalimet	-----
